

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Master Profesional në “Drejtësi”, me profile: a) E drejtë administrative; b) E drejtë ndërkombëtare dhe c) E drejtë evropiane

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

1. Prof.Dr. Eralda (Methasani) Çani
2. Prof. Asoc. Mirela Bogdani



Qershor, 2018



RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesional në “Drejtësi”, me profile: a) E drejtë administrative; b) E drejtë ndërkombëtare dhe c) E drejtë evropiane

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti Juridik Departamenti i së Drejtës Publike
3	Urdhëri/VKM i licencimit	VKM Nr.74, datë 21.01.2009
4	VKA/Urdhëri i Akreditimit të parë	VKA Nr. 133, datë 21.12.2010 UMASH Nr. 68, datë 14.02.2011
5	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në “Drejtësi”, me profile: a) E drejtë administrative; b) E drejtë ndërkombëtare, dhe c) E drejtë evropiane
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik*
8	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët/dyfishtë	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7 (shtatë)
15	Numri i studentëve	39 studentë (viti akademik 2017-2018)

*Programi i studimit, deri në vitin akademik 2015-2016, është ofruar me 60 ose 90 ECTS dhe me kohëzgjatje 1.5 vite akademike. Nga viti akademik 2016-2017, programi i studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ofrohet vetëm me 60 ECTS dhe kohëzgjatje 1 vit akademik.

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Master Profesional në “Drejtësi”, me profile: a) E drejtë administrative; b) E drejtë ndërkombëtare, dhe c) E drejtë evropiane.

Programi i ciklit të dytë, Master Profesional në "Drejtësi" me profile: a. E drejtë administrative; b. E drejtë ndërkombëtare; c. E drejtë evropiane, është hapur si program studimi mbështetur në VKM Nr. 74, datë 21.01.2009 *“Për hapjen e programeve të reja të studimit, të ciklit të dytë, në Shkollën e Lartë Universitare Private “Universiteti Evropian i Tiranës”*¹, si program i ciklit të dytë, “Master i nivelit të parë”, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik dhe me, së paku, 60 kredite. Në përfundim të studimeve, sipas VKM-së, lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë" (MNP), në fushën përkatëse. Bazuar në Vendimin Nr. 133 datë 12.12.2010 të Këshillit të Akreditimit, *“Për akreditimin e programit të studimit Master i Nivelit të Parë në “Drejtësi” me 3 profile a. E Drejtë Administrative; b. E Drejtë Ndërkombëtare; c. E Drejtë Evropiane”*, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, me Urdhërin Nr. 68 datë 14.2.2011, miratoi akreditimin e këtij programi studimi (pika 2 e Urdhërit). Me Urdhër Nr. 218, datë 23.05.2011, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka urdhëruar regjistrimin e formatit të diplomave të programit të studimit Master Profesional në “Drejtësi” me 3 profile, a. E drejtë administrative; b. E drejtë ndërkombëtare; c. E drejtë evropiane (gërma A e Urdhërit). Me Urdhër Nr. 380, datë 12.10.2015, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka urdhëruar ri-regjistrimin e formave të diplomave të paraqitura nga UET, përfshirë edhe Masterin Profesional në “Drejtësi” me 3 profile, a. E drejtë administrative; b. E drejtë ndërkombëtare; c. E drejtë evropiane, në regjistrin shtetëror të diplomave (gërma B e Urdhërit). Me Vendimin Nr. 7, datë 14.09.2016, Senati Akademik i Universitetit Evropian të Tiranës, ka miratuar ofrimin e programeve të ciklit të dytë Master Profesional, në të tre fakultetet e UET-së, pra edhe Fakultetin e Drejtësisë, duke nisur nga viti akademik 2016-2017, me 60 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje normale 1 (një) vit akademik. Me Shkresë Nr. 8571/1 Prot., datë 08.01.2018, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka kthyer përgjigje se: *“...përshtatja e programeve të studimit nga MNP në MP bëhet nga vetë IAL si detyrë e tyre sipas neneve 99/2 pika 4 dhe 99/3 pika 2 e Ligjit 9741, 2007 “Për Arsimin e Lartë” dhe me Shkresat Nr. 367/1 Prot., datë 14.2.2018 dhe Nr. 790/1 Prot., datë 19.02.2018, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ka konfirmuar se: “...ndryshimet e bëra në programet e ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” janë si rrjedhojë e përshtatjes me Ligjin e ri të Arsimit të Lartë, Neni 75, pika 6, Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.*

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Dr. Eralda (Methasani) Çani
2. Prof. Asoc. Mirela Bogdani

Gjatë zhvillimit të procedurës, GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Znj. Ersi Dako.

¹ Shih në: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2009/PDF-2009/8-2009.pdf

Më datë 26.06.2018, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 25/43 Prot., me lëndë “Njoftim për dërgimin e Draft-Raporteve të Vlerësimit të Jashtëm”, Institucioni është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 29.06.2018, Institucioni, përmes shkresës zyrtare Nr. 10/35 Prot., me lëndë “Dërgohen komentet në lidhje me Draft-Raportet e Vlerësimit të Jashtëm për programet e studimit Master Profesional”, përcjell përgjigjen se: “*Institucioni nuk ka komente shtesë lidhur me programin e studimit MP. Drejtësi*”.

Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm merr statusin e Raportit përfundimtar të Vlerësimit të Jashtëm.



ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit në VKA Nr. 133, datë 21.12.2010

- a. Të forcohet roli i strukturave kontrolluese për rritjen e efektivitetit sidomos në fushën e kërkimit shkencor;
- b. Në departamente të krijohen grupet mësimore kërkimore si njësi bazë për të menaxhuar më mirë si mësimdhënien ashtu edhe aktivitetin kërkimor;
- c. Fakulteti/Departamentet të shohin me përparësi rritjen e shkallës së kualifikimit të personelit akademik, që të gjithë titullarët e lëndëve të kenë gradën shkencore doktor;
- d. Institucioni të punojë për punësimin me kohë të plotë të personelit të brendshëm dhe të mos lejojë dy punësimin me kohë të plotë;
- e. Të aktivizohen më shumë ekspertë, edhe me statusin e “guest speaker”, për të realizuar më mirë shkëmbimin e përvojave edhe me universitetet e tjera por edhe me ekonominë;
- f. Në të gjitha programet të mos lejohet dhënia nga një titullar e më shumë se dy lëndëve;
- g. Të bëhet i detyrueshëm disponimi i materialit bazë (leksione të shkruara) në shqip;
- h. Të normohet numri i faqeve të leksioneve të shkruara në rreth 10-15 faqe për leksion;
- i. Të rishikohet profilizimi më i qartë i disa planeve mësimore si p.sh, te programi “MNP Shkenca Komunikimi”, “MND Marrëdhënie Ndërkombëtare”, etj;
- j. Kurrikulat të përcaktojnë më qartë dhe më thjeshtë literaturën bazë të detyruar, pasi në disa lëndë ajo është e mbingarkuar;
- k. Të shikohet mundësia e ngarkesave në planet mësimore për ta bërë më intensiv procesin e angazhimit të studentit (diferencime në numrin e krediteve për lëndë të veçanta);
- l. Të harmonizohet më mirë shpërndarja e mësimdhënies në kohë gjatë javës;
- m. Të vazhdohet puna e nisur me Universitetet perëndimore, me të cilat janë lidhur marrëveshje dhe mundësisht, të shtohen kontaktet me universitetet e tjera;
- n. Të shihet mundësia e aplikimit të ndonjë modeli perëndimor në plotësimin e përmirësimin e planeve mësimore;
- o. Të përmirësohet bashkëpunimi me universitetet në vend, për të thithur kontingjente të interesuara për ciklin e studimeve DND, MNP e MND në UET, duke ekspozuar më mirë kriteret e pranimit;
- p. Të rriten e forcohen kontaktet me punëdhënësit brenda e jashtë vendit për të rritur sigurinë e punësimit të studentët;
- q. Të shihet mundësia e aplikimit të kriterit të mesatares, mbase dhe ajo e përdorimit të gjuhës angleze, për studentët e diplomave DND, MNP e MND;
- r. Të shihet mundësia e uljes së tarifës të studimeve duke vendosur raporte më eficiente në shpenzimet p.sh., reklamat publicitare, për të rritur më tej interesimin e kontigjenteve më cilësore;

- s. Të rriten të ardhurat nga aktiviteti kërkimor, duke u angazhuar në tematika që kanë interes për ekonominë e vendit tonë;
- t. Të synohet botimi i monografive me interes për institucione kërkimore shkencore brenda e jashtë vendit;
- u. Të rritet më tej përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor;
- v. Të pasurohet më tej fondi i bibliotekës edhe me literaturë të huaj dhe literaturë në shqip, kryesisht në funksion të plotësimit të nevojave të kurrikulave.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

A. Rekomandimet nga Vendimi nr. 133, datë 21.12.2010 i Këshillit të Akreditimit

- a) Për rekomandimin në gjermën “a)” *“Të forcohet roli i strukturave kontrolluese për rritjen e efektivitetit sidomos në fushën e kërkimit shkencor”*, GVJ konstaton që Institucioni u ka dhënë kompetenca Organeve Drejtuese në bazë të një hierarkie, në lidhje me të drejtën e planifikimit, organizimit, garantimit të politikave, vizionit dhe procedurave të ndjekura në UET. Roli kontrollues mbi veprimtarinë mësimore dhe kërkimin-shkencor realizohet si më poshtë:
- Senati Akademik, sipas statutit të UET, ka ndër të tjera si kompetencë që të miratojë planin vjetor të veprimtarisë akademike dhe të kërkimit-shkencor, garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë, si edhe krijon mekanizma për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, (neni 19.2.7, gjermat “e”, “h” dhe “i”).
 - Rektori është një tjetër strukturë e cila ka të drejtë që të paraqesë rekomandime për projektet dhe kërkimin shkencor si edhe monitoron vazhdimisht rezultatet e veprimtarisë së IAL-së (Statuti, neni 19.3.1, gjermat “e” dhe “g”). Dekanati ka të drejtë që t’i propozojë Senatit programe të reja studimi ose të kërkimit shkencor, si edhe ndryshime në programet ekzistuese, si edhe shqyrton dhe miraton raportin e Dekanit për veprimtarinë mësimore dhe të kërkimit shkencor (Statuti, neni 19.5.2, gjermat “d” dhe “j”).
 - Rektori, i cili drejton procesin akademik dhe shkencor në UET, garanton lirinë e kërkimit shkencor, organizon kontrolle për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit-shkencor, administron kërkimin shkencor (Statuti, neni 20.3.4, gjermat “d”, “i”, “j” dhe “k”).
 - Dekani i cili organizon dhe drejton aktivitetin mësimor dhe kërkimor-shkencor të fakultetit si edhe raporton në lidhje me to (Statuti, neni 20.4.2, gjermat “f” dhe “i”).
 - Përgjegjësi i Departamentit, i cili ka në kompetencë që të organizojë, koordinojë dhe drejtojë veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore të departamentit, si edhe bën vlerësimin e pedagogëve, ku përfshihet dhe vlerësimi për aktivitetin kërkimor-shkencor (Statuti, neni 20.5.5, gjermat “a” dhe “f”).
 - Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore-Shkencore, i cili ushtron kompetencat e tij në lidhje me kërkimin shkencor në nivel universiteti dhe përgjigjet për realizimet e anëtarëve të qendrës (Statuti, neni 20.7.5).

Të gjitha institucionet e mësipërme, bashkëpunojnë në mënyrë të ndërthurur me njëri tjetrin, duke filluar që nga njësia bazë Departamenti e deri në nivelin e Dekanatit dhe Rektoratit për të planifikuar, realizuar dhe kontrolluar veprimtarinë kërkimore-shkencore (shih RVB fq. 4); në këtë proces jo vetëm janë shtuar burimet financiare por rol të madh luan edhe Zyra e Projekteve të Kërkimit dhe Zhvillimit, në projekte me financim të brendshëm dhe ndërkombëtar.

Gjithashtu, për rekomandimin (a) institucioni ka ngritur si institucion të përhershëm të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Kjo strukturë sipas nenit 11 të Statutit të UET-së harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm, ku përfshihen edhe fusha e kërkimit shkencor, konkretisht për përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulave dhe përditësimin e tyre me literaturë shtesë.. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësitë e UET-së. Kjo njësi ka të drejtë të propozojë masa dhe ndryshime konkrete për përmirësimin e cilësisë. Në kuadër të kontrollit të efikasitetit të kërkimit shkencor IAL ka vendosur aplikimin e Indikatorëve të Matjes së Performancës Kërkimore Shkencore.

Për sa më sipër, GVJ konkludon që rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht.

- b) Për rekomandimin në gjermën “b)” *“Në departamente të krijohen grupet mësimore kërkimore si njësia bazë për të menaxhuar më mirë si mësimdhënien ashtu edhe aktivitetin kërkimor”*, GVJ konstaton se në programin e studimit në fjalë, lëndët e ngjashme janë grupuar në grup lëndë. Grup lënda përbën njësinë bazë të mësimdhënies. Ato kryesohen nga përgjegjësit përkatës të cilët emërohen nga Rektori me propozim të përgjegjësit të Departamentit (Neni 20.6 i Statutit të IAL). Detyrat e përgjegjësit të grup lëndës përfshijnë rishikimin e syllabuseve të lëndës, miratimin e tezave të provimeve dhe temave të detyrave të kursit, kontrollin e përputhshmërisë së temave të diplomave me fushën kërkimore të pedagogut. (Neni 20.6 i Statutit të IAL). Gjithashtu institucioni ka ngritur dhe njësitë kërkimore në kuadër të Platformës Shqipëria Inovative dhe Strategjisë së Kërkimit. Për periudhën 2017-2020 janë ngritur tre grupe kërkimore që lidhen me programin e studimit në fjalë. Grupi i parë kërkimor mbi “Çështje të migracionit. Rregullimi kombëtar dhe ndërkombëtar” kryesohet nga Prof. Asoc. Dr. Erjona Canaj; grupi i dytë kërkimor mbi “Arbitration Law: Practice and Procedure” kryesohet nga Dr. Evelina Bach Jensen dhe grupi i tretë kërkimor mbi “Aspekte të problematikave aktuale të Gjykatave Administrative në Shqipëri” kryesohet nga Dr. Ledina Shkurti. Sipas të dhënave të paraqitura, grupi i parë dhe i tretë kërkimor kanë përkatësisht dy dhe katër anëtarë, ndërsa grupi i dytë kërkimor nuk ka asnjë anëtar.

GVJ konkludon që, për sa i takon ngritjes së strukturave bazë të mësimdhënies dhe kërkimit, rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht. Duhet parë se si, sidomos, grupet kërkimore ndikojnë në menaxhimin dhe përmirësimin e output-eve të kërkimit shkencor.

- c) Për rekomandimin në gjermën “c)” *“Fakulteti/Departamentet të shohin me përparësi rritjen e shkallës së kualifikimit të personelit akademik, që të gjithë titullarët e lëndëve të kenë gradën shkencore doktor”*, institucioni ka marrë masa që personeli akademik efektiv të ketë gradën shkencore doktor.

GVJ konkludon që rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht.

d) Për rekomandimin në gjermën "d)" "*Institucioni të punojë për punësimin me kohë të plotë të personelit të brendshëm dhe të mos lejohet dy punësimin me kohë të plotë*", **GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.**

e) Për rekomandimin në gjermën "e)" "*Të aktivizohen më shumë ekspertë, edhe me statusin e "guest speaker", për të realizuar më mirë shkëmbimin e përvojave edhe me universitetet e tjera por edhe me ekonominë*", GVJ konstaton në bazë të informacionit të vënë në dispozicion nga IAL, që ky i fundit ka angazhuar disa ekspertë si të ftuar, qoftë nga akademia, qoftë nga praktika megjithatë në të ardhmen, mund të shikohet mundësia për të shtuar numrin e ekspertëve të fushës në disa module, për të diversifikuar njohuritë teorike me ato praktike, pasi edhe programi i studimit lidhet me profile të së drejtës administrative, ndërkombëtare dhe evropiane.

GVJ konkludon që rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht.

f) Për rekomandimin në gjermën "f)" "*Në të gjitha programet të mos lejohet dhënia nga një titullar e më shumë se dy lëndëve*", institucioni ka marrë masa që në programin e studimit në fjalë një titullar të mos japë më shumë se dy lëndë.

GVJ konkludon që rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht.

g) Për rekomandimin në gjermën "g)" "*Të behet i detyrueshëm disponimi i materialit bazë (leksione të shkruara) në shqip*", institucioni ka marrë masa që në një pjesë të madhe të lëndëve, literatura e detyrueshme të jetë në shqip. Megjithatë ka dhe raste që kjo literaturë është në gjuhë të huaj, gjë që diktohet dhe nga natyra e programit të studimit (e drejtë ndërkombëtare/europiane dhe krahasuese). Gjatë takimit me grupin e vlerësimit të brendshëm u pranua që kjo temë përbën një debat të vazhdueshëm.

GVJ vlerëson se studentët e programit Master duhet të jenë në gjendje që përveç njohurive të thelluara që marrin në gjuhën shqipe, të kenë mundësi të aksesojnë edhe literaturë në gjuhë të huaj, në kuadrin e globalizimit të dijeve dhe të unifikimit të programeve e literaturës bashkëkohore me atë të universiteteve të huaja. Kjo gjë i shërben edhe avancimit të njohurive të gjuhës së huaj ligjore, dhe i aftëson studentët që të përballen më mirë me tregun e punës, të kryejnë kërkim ligjor në gjuhë të huaj dhe të zhvillojnë programe Erasmus në universitete të huaja, pa vështirësi.

GVJ konkludon që rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht për sa kohë që IAL është i ndërgjegjshëm për rëndësinë e pasjes së materialit bazë në gjuhën shqipe dhe merr masa për të ruajtur një ekuilibër me materialet në gjuhë të huaj.

h) Për rekomandimin në gjermën "h)" "*Të normohet numri i faqeve të leksioneve të shkruara në rreth 10-15 faqe për leksion*", janë marrë masat përkatëse. Stafi akademik i institucionit shpërndan leksione të shkruara dhe leksione në formën e power point. Gjatë takimit me grupin e vlerësimit të brendshëm u pranua që kjo temë përbën një debat të vazhdueshëm, megjithatë mbetet në vlerësimin e secilit pedagog, të Departamentit, Dekanatit dhe

Rektoratit për të gjykuar në të ardhmen 'normimin' sasior lidhur me numrin e faqeve të leksioneve të shkruara që pedagogët duhet t'u shpërndajnë studentëve për çdo orë leksioni e seminari. Programi i studimit kërkon më shumë aftësim praktik, ndaj leksionet e shkruara do të konsideroheshin si baza e materialit mbi të cilin do të diskutohen kazuset dhe rastet praktike.

GVJ konkludon që rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht.

- i) Për rekomandimin në gjermën "i)" *Të rishikohet profilizimi më i qartë i disa planeve mësimore si MNP Shkenca Komunikimi, MND Marrëdhënie Ndërkombëtare, etj*",

GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

- j) Për rekomandimin në gjermën "j)", *"Kurrikulat të përcaktojnë më thjeshtë dhe më qartë literaturën bazë të detyruar, pasi në disa lëndë ajo është e mbingarkuar"*, institucioni ka marrë masa që literatura të jetë e përshtatshme për programin e studimit, të mos ketë përsëritje apo mbivendosje të saj, dhe të adresojë kryesisht edhe problemet praktike ligjore në fushat e profileve.

GVJ konkludon që rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht.

- k) Për rekomandimin në gjermën "k)" *"Të shikohet mundësia e ngarkesave në planet mësimore për ta bërë më intensiv procesin e angazhimit të studentit (diferencime në numrin e krediteve për lëndë të veçanta)"*, GVJ konstaton se në vitet 2014-2015, 2015-2016, dhe 2017-2018, secila nga të dhjetë lëndët e programit mësimor përmban 6 kredite (ECTS), përveç punimit të diplomës (14 kredite) dhe Praktikës/Internship (10 kredite); megjithatë të gjitha lëndët e parashikuara dhe të ofruara për programin Master në "Drejtësi", me profile janë të rëndësishme dhe rezultojnë të vështirë ri-ndarja a krediteve; ajo që mund të bëhet në këtë drejtim, nëse rezultojnë të vështirë ri-ndarja në kredite është të shtohet numri i lëndëve me zgjedhje, në mënyrë që studenti të ketë mundësi të zgjedhë të formohet në mënyrë të specializuar, sipas interesave të tij profesionalë.

GVJ konkludon që rekomandimi plotësohet pjesërisht.

- l) Për rekomandimin në gjermën "l)" *"Të harmonizohet më mirë shpërndarja e mësimdhënies në kohë gjatë javës"*, institucioni ka marrë masa që mësimdhënia të shpërndahet çdo ditë nga ora 17:00-20:00 gjatë javës dhe ditën e shtunë.

GVJ konkludon që rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht.

- m) Për rekomandimin në gjermën "m)" *"Të vazhdohet puna e nisur me Universitetet perëndimore, me të cilat janë lidhur marrëveshje dhe mundësisht, të shtohen kontaktet me universitetet e tjera"*, institucioni ka ndërmarrë masa dhe vazhdon të ndërmarrë iniciativa bashkëpunimi në rang UET dhe në rang programi studimi, të cilat edhe në rastet kur nuk lidhen drejtpërdrejt me programin, kanë vlerë të shtuar pasi së pari lidhen në mënyrë të pandarë me njëri-tjetrën, dhe së dyti sepse tregojnë modele suksesi tek studentët e tjerë duke ndikuar që edhe ata studentë që nuk janë përfshirë individualisht në programe shkëmbimi,

të njihen me mundësitë nëpërmjet studentëve të tjerë dhe të nxiten për të provuar eksperiencën të ngjashme.

GVJ konkludon që rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht.

n) Për rekomandimin në gjermën “n)” *“Të shihet mundësia e aplikimit të ndonjë modeli perëndimor në plotësimin e përmirësimit e planeve mësimore”*, institucioni ka ngritur disa organe këshillimore si edhe ka caktuar edhe ekspertë të jashtëm (shih dokumentin “Vendimi për caktimin e ekspertëve të jashtëm”, “Procedura e ndryshimit të kurrikulave” si edhe “Përfshirja e mendimeve të studentëve dhe Bordit të Tregut të Punës për përmirësimin e kurrikulës”), me qëllim përmirësimin e programeve mësimore sipas standardeve dhe modeleve perëndimore natyrisht duke respektuar edhe traditën ligjore të deritanishme dhe kontekstin kombëtar.

GVJ konkludon që rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht.

o) Për rekomandimin në gjermën “o)” *“Të përmirësohet bashkëpunimi me universitetet në vend, për të thithur kontingjente të interesuara për ciklin e studimeve DND, MNP e MND në UET, duke ekspozuar më mirë kriteret e pranimit”*, institucioni ka marrë masa për organizimin e ‘Open days’ si dhe ka intensifikuar marketingun e këtyre programeve, duke lançuar histori suksesi të studentëve të diplomuar, të aktiviteteve jashtë-universitare, të pedagogëve që kanë marrë pjesë në debate televizive, etj.

GVJ konkludon që rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht.

p) Për rekomandimin në gjermën “p)” *“Të rriten e forcohen kontaktet me punëdhënësit brenda e jashtë vendit për të rritur sigurinë e punësimit të studentët”*, **GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.**

q) Për rekomandimin në gjermën “q)” *“Të shihet mundësia e aplikimit të kriterit të mesatares, mbase dhe ajo e përdorimit të gjuhës angleze, për studentët e diplomave DND, MNP e MND”*, institucioni aplikon kuotat e pranimit të studentëve të cilat, në pikëpamje të IAL, në mënyrë të tërthortë favorizojnë pranimin e studentëve me mesataren më të lartë. Për sa i përket gjuhës së huaj, kjo pjesë e rekomandimit nuk lidhet me këtë program studimi.

Për sa më sipër, GVJ konkludon që rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht.

r) Për rekomandimin në gjermën “r)” *“Të shihet mundësia e uljes së tarifës të studimeve duke vendosur raporte më efçiente në shpenzimet psh., reklamat publicitare, për të rritur më tej interesimin e kontigjenteve më cilësore”*,

GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

s) Për rekomandimin në gjermën “s)” *“Të rriten të ardhurat nga aktiviteti kërkimor, duke u angazhuar në tematika që kanë interes për ekonominë e vendit tonë”*,

GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

t) Për rekomandimin në gërmën “t)” *“Të synohet botimi i monografive me interes për institucione kërkimore shkencore brenda e jashtë vendit”*, GVJ konstaton se një pjesë e vogël e personelit akademik efektiv të programit të studimit në fjalë, ka publikuar monografi që reflektojnë punën e tyre kërkimore dhe që mund të jenë me interes për institucione kërkimore shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ndërkohë, IAL-UET ka përkthyer një sërë botimesh ligjore nga gjuhë të huaja, të lidhura me institute të ndryshme të së drejtës, që favorizon njohjen e thelluar në një fushë të caktuar; ndonëse jo monografi të mirëfillta në kontekstin shqiptar, këto përkthime janë me qasje monografike, dhe mund të shfrytëzohen nga studentët dhe nga stafi për çdo rast.

GVJ konkludon që rekomandimi konsiderohet i plotësuar kryesisht.

u) Për rekomandimin në gërmën “u)” *“Të rritet më tej përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor”*, GVJ konstaton se institucioni ka paraqitur të dhëna për një rritje të përfshirjes të studentëve në aktivitetin shkencor, në nivel IAL; në nivelin e programit të studimit Master Profesional në “Drejtësi” me profile, qasja është më tepër praktike se sa shkencore, megjithatë pedagogët, kur shohin që studentët kanë interes dhe janë të motivuar, i kanë përfshirë studentët në procese kërkimore shkencore, edhe pse sporadike.

GVJ konkludon që rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht.

v) Për rekomandimin në gërmën “v)” *“Të pasurohet më tej fondi i bibliotekës edhe me literaturë të huaj dhe literaturë në shqip, kryesisht në funksion të plotësimit të nevojave të kurrikulave”*, GVJ konstaton se institucioni ka marrë masa për pasurimin e bibliotekës. Për këtë qëllim është formalizuar një procedurë për planifikimin e blerjeve të reja çdo vit, si edhe janë bërë dhe abonime në biblioteka online. Megjithatë një pjesë e vogël e literaturës së detyrueshme nuk gjendet në listën e inventarit të bibliotekës.

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i plotësuar kryesisht për sa kohë që një pjesë e vogël e literaturës së detyrueshme nuk gjendet në bibliotekë.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkimore

Programi i studimit i ciklit të dytë “Master Profesional” në "Drejtësi", me profile, ofrohet nga Fakulteti Juridik. Ai ofron mundësinë e profilizimit në këto drejtime: a) E drejtë administrative; b) E drejtë ndërkombëtare dhe c) E drejtë evropiane. Ky program studimi rezulton të ketë mision/objektiva dhe vizion në përputhje me ato të IAL-së, në përputhje me Nenin 6 të Statutit të UET. Sipas këtij dokumenti zyrtar, misioni i këtij institucioni është ofrimi i një edukimi cilësor duke përthyer në të rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm, si dhe për ti shërbyer shoqërisë dhe kreativitetit si dhe ndërtimit të partneriteteve të tregut të punës e atyre ndërkombëtare. Vizioni i UET është të kthehet në një qendër ekselence në vend, rajon e më gjerë. Vizioni, misioni dhe objektivat janë të pasqyruara edhe përmes objektivave strategjike, në plane të ndryshme, miratuar në Planin Strategjik 2015 – 2020 të UET-së.

Statuti i Universitetit është i rishikuar në përputhje me Ligjin e ri për Arsimin e Lartë dhe është miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 90, datë 28.02.2017 “Për miratimin e statutit të Universitetit Europian të Tiranës”. Në këtë dokument rregullohet veprimtaria e brendshme e institucionit, organizimi dhe funksionimi i organeve drejtuese dhe vendimmarrëse, si dhe veprimtaria akademike dhe shkencore e tij. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u njoh edhe me aktet e tjera në zbatim të Statutit si: Rregullorja e UET dhe e programit Master Profesional në “Drejtësi”. Aktet pasqyrojnë strategjinë e zhvillimit të institucionit si dhe të drejtat dhe detyrat e personelit akademik dhe administrativ, funksionimin e programeve të studimit, etj., edhe pse nga kopja e depozituar, në sistemin e-ASCAL dhe atë të treguar gjatë vizitës në Institucion nga një prej pedagogëve të Institucionit në folderin që disponon secili prej tyre, rezulton se në këto rregullore duhet të reflektohen disa përshtatje me Ligjin e ri Nr. 80/2015 Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur, me qëllim punësimin, ose kualifikimin në një drejtim të ngushtë (Pika 3.3.1. e Rregullores së Programit të Studimit). Të tre profilet e këtij programi janë të lidhura ngushtë me nevojat e tregut, posaçërisht të administratës publike, dhe së dyti me ato të tregut rajonal evropian, rëndësia e të cilit për vendin tonë, një vend me statusin e Vendit Kandidat, është e padiskutueshme, dhe atij ndërkombëtar.

Vlerat që UET kërkon të transmetojë nëpërmjet dijes në programin në "Drejtësi" me profile: a) E drejtë administrative; b) E drejtë ndërkombëtare dhe c) E drejtë evropiane, të strukturuar, i bëhen me dije studentit që në fillim përmes procesit të orientimit të tij, si dhe Guidës së Studentit, një dokument i mirë-strukturuar dhe i detajuar në informacione (Shih: https://issuu.com/uet.edu.al/docs/broshura_uet_2017-2018_print). Po ashtu, faqja e internetit e UET është një referencë e mirë për informacion të gjerë, për studentët e këdo.

Në kushtet aktuale, kur programet e studimit në Drejtësi, po shkojnë drejt integritit të tyre, në momentin kur IAL-UET do të ndërmarrë hapa drejt miratimit dhe aplikimit të programeve të integruara, do të përballet me sfidën e ri-konceptimit edhe të programit Master Profesional me profile, në reflektim të kërkesave të parashikuara në Ligjin Nr. 80/2015 'Për Arsimin e Lartë'.



Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional” në "Drejtësi" me profile: a) E drejtë administrative; b) E drejtë ndërkombëtare dhe c) E drejtë evropiane, i ofruar nga Fakulteti Juridik, i cili lidhet më së shumti me formimin kryesisht praktik të studentit për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur, me qëllim punësimin, ose kualifikimin në një drejtim të ngushtë, është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit. Ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës duke ofruar profilizime në fusha me interes angazhimi e punësimi aktuale, si brenda vendit, ashtu edhe më gjerë, bazuar në një studim të tregut të punës të hartuar nga institucioni sipas RVB (fq. 14), por që GVJ-së nuk iu dha ndonjë dokument lidhur me studime të tilla, me përjashtim të atij të realizuar nga ALUMNI.</p> <p>Ky program synon ta pajisë studentin kryesisht me: koncepte të aplikuara, të specializuara; përgatitje të lidhur ngushtë me profesionin e rregulluar ose licencën/at; formim nëpërmjet kurseve praktike, aplikative, laboratorëve; aftësi praktike aplikative në profesionin përkatës; njohuri teorike bazë të fushës së studimit; mundësi për stazh, internship të zgjeruar në operatorët kryesorë të tregut të punës; përfshirje në shoqatat profesionale, korporatat profesionale; aftësim për zhvillim karriere dhe integrim në tregun e punës, dhe si rrjedhojë pajisjen me një diplomë të karakterit praktik, aplikativ, në formën e një studimi rasti, punë praktike ose produkt profesional.</p> <p>Ky program studimi i jep mundësi studentëve të kenë akses në profesionet si: 1. Avokat, 2. Noter, 3. Jurist në administratë publike (niveli qendror/vendor), 4. Jurist në institucione të pavarura (p.sh. KLSH, Avokati i Popullit, Avokati i Prokurimeve, etj.), 5. Jurist në firma/biznese private, 6. Jurist në OJF vendase/ të huaja dhe organizma ndërkombëtare.</p> <p>Programi i studimit është konkurrues në një treg kombëtar dhe ndërkombëtar, për shkak të elementëve përbërës të tij si: profilet, plani mësimor/ kurrikula, programet e lëndëve, kreditet (ECTS), metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve sipas njohurive të fituara.</p> <p>Programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon të ruajë ato vlera kulturore kombëtare që lidhen në mënyrë më të drejtpërdrejtë me këtë program studimi. Sipas RVB-së (fq. 15), një rol me rëndësi në këtë drejtim ka pasur</p>

	edhe nisma EUT_ Universiteti i Biznesit 2014-2015 (Raporti lidhur me këtë nismë gjendet në: http://uet.edu.al/images/Raport_narrativ_UET_Alumni_2014-2015_AL.pdf)
--	---

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>IAL ka miratuar Planin Strategjik 2015 –2020 të UET-së dhe programi MP në “Drejtësi”, me profile, është i përshtatur me të. Kjo Strategji synon që UET të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - jetë një universitet masiv por cilësor; - ketë profilizimin e një universiteti që i jep përparësi ndërtimit të kurrikulave, strukturës së programeve e diversitetit të diplomave e profileve sipas kërkesave të tregut të punës në nivel kombëtar e rajonal; - ruajë profilizimin kryesor në shkencate jurisprudencës, etj., - ketë strukturë të qëndrueshme financimi. <p>Një shembull konkret i kësaj është, siç shprehet edhe në RVB (fq. 29), parandalimi dhe lufta ndaj plagjiaturës në kërkim e shkencë, përmes sistemit LMS (Learning Management System).</p> <p>Në këtë program janë realizuar si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - janë përditësuar kurrikulat; - është shtuar stafi akademik me pedagogë me eksperiencë dhe/ose formim në universitete të huaja prestigjioze; - janë përkthyer nga Shtëpia Botuese UET Press botime të huaja në gjuhën shqipe; - janë organizuar aktivitete të ndryshme akademike si: konferenca, ditët studimore, tryeza të rumbullakëta, mbledhje të klubeve studentore, leksione të hapura; - është realizuar pjesëmarrja në projekte kërkimore, individuale apo grupi; - është nxitur kualifikimi i mëtejshëm i stafit akademik; - janë përdorur mjetet informatike në funksion të përmirësimit të cilësisë, si sistemi antiplagjiaturë EPHORUS dhe LMS, etj.
---	--

Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional” në "Drejtësi" me profile: a) E drejtë administrative; b) E drejtë ndërkombëtare dhe c) E drejtë evropiane, i ofruar nga Fakulteti Juridik, është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat lidhen me fushën e studimit, emërtimin e programit, nivelin dhe kapacitetet akademike të njësisë ku zhvillohet ky program</p>
--	---

<p>programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>studimi. Ky program studimi Master Profesional është në përputhje me emërtimin e titullit të diplomës përkatëse (të realizuar me 60 kredite ECTS e kohëzgjatje normale 1 (një) vit akademik). Ai është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Gjithsesi, rezulton se rregullorja e këtij programi duhet të përshtatet me Ligjin e ri Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>IAL-ja ka miratuar Planin Strategjik 2015 – 2020 të UET-së për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve, e cila përcakton se UET:</p> <ul style="list-style-type: none"> - konsideron procesin mësimor si një nga prioritetet më të rëndësishme; - vë në funksion të procesit mësimor maksimumin e burimeve njerëzore e financiare si dhe mjetet dhe metodat më efikase administrative e institucionale; - objektiv primar ka rritjen e vazhdueshme të cilësisë së formimit të studentëve përmes metodave dhe teknikave më bashkëkohore të mësimdhënies dhe duke nxitur të qenin pro aktiv e kritik në dhënien e opinionëve mbi çështje aktuale; - ushtron veprimtarinë në bazë të parimeve të Procesit të Bolonjës; - synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave të tij në përputhje me eksperiencën më të mirë të universiteteve perëndimore, kërkesave të “Kartës së Bolonjës”, përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut, mundësinë e përvetësimit sa më të mirë të tyre, etj. <p>Po aq, UET synon të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përfshijë studentë në nivele vendimmarrëse të universitetit si dhe në kërkim shkencor, botime akademike, aktivitete kërkimor-shkencor, etj. - angazhojë ata përmes rrjetit ALUMNI, që funksionon aktivisht madje pranë UET, etj. <p>Me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, aplikohen mekanizma të ndryshëm si (RVJ-ja pa në IAL shembuj konkretë të sa vijon):</p> <ul style="list-style-type: none"> - monitorimi i zhvillimit të procesit mësimor (lidhur me mirëfunksionimin e programit në tërësinë e tij), personelit të sekretarisë mësimore dhe zyrës së burimeve njerëzore

(në lidhje me realizimin e tij në aspektin formal), të cilat GVJ-ja i këqyri gjatë vizitës në IAL;

- vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga përgjegjësi i departamentit ose një koleg i caktuar prej përgjegjësit, Komisionit të Vlerësimit të Performancës dhe KSBC-ja si dhe nga studentët në javën e 12/13 të mësimdhënies përmes formularëve online të vlerësimit të pedagogëve;
- ekspertëve të jashtëm të angazhuar periodikisht nga IAL-ja me qëllim vlerësimin e pavarur të programit të studimit dhe të programeve të lëndëve mësimore;
- aplikimi i indikatorëve të performancës lidhur me punën kërkimore shkencore të personelit akademik;
- krijimi i fokus grupeve me studentët ekselentë (mesatare mbi 8) për zhvillimin e procesit mësimor si dhe problematikat e tjera që nevojitet t'u bëhen me dije drejtuesve të programit dhe të institucionit;
- përfshirjes së studentëve në organet drejtuese të UET-së dhe në mbledhjet e departamenteve.

Gjithashtu, me anë të akteve të brendshme, është bërë një rishikim i lëndëve që aktualisht ofrohen në këtë program studimi me qëllim reflektimin në përmirësimin e kapaciteteve akademike të departamentit, kërkesat e studentëve dhe të tregut të punës (3 ndryshime të tilla). Tregues i cilësisë së programit të studimit është edhe shkalla e punësimit të të diplomuarve.

Institucioni është angazhuar në përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit nëpërmjet:

- formimit të pedagogëve me trajnime lidhur me metodologjinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;
- inkurajimit të pedagogëve për pjesëmarrje në aktivitete kërkimore e shkencore dhe nxitjen e debatit mediatik në fushat përkatëse;
- zgjerimit të shërbimeve mbështetëse infrastrukturore e teknologjike, si interneti apo portali i pedagogut, përfshirë edhe pasurimin e bibliotekës, etj.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. GVJ vlerëson se programi i studimit Master Profesional në “Drejtësi” është hartuar dhe administrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, **për rrjedhojë standardi I.1 plotësohet;**
2. Programi i studimit është në përputhje me strategjinë e institucionit, **për rrjedhojë standardi I.2 plotësohet;**
3. Programi i studimit është hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit, bazohet në një plan strategjik për zhvillimin dhe përmirësimin e tij si dhe të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit, me sugjerimin që rregullorja të reflektojë

ligjin e ri të arsimit të lartë, **për rrjedhojë standardi I.3 plotësohet kryesisht.** *GVJ sugjeron që IAL-UET duhet të nisë punën e ri-konceptimit të këtij programi pas miratimit dhe aplikimit të programeve të integruara në drejtësi, në reflektim të kërkesave të parashikuara në Ligjin Nr. 89/2015 'Për Arsimin e Lartë'.*

4. GVJ vlerëson se IAL-ja ka miratuar një Plan Strategjik për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve 2015 – 2020, aplikon mekanizma të ndryshëm të ruajtjes së cilësisë dhe reflekton ndryshime në programin e studimit sipas nevojave dhe kërkesave të tregut, **për rrjedhojë standardi I.11 plotësohet.**

GVJ konkludon se standardet e lidhura me rubrikën 1 “Misioni/objektivat e programit të studimit” plotësohen plotësisht.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Në bazë të Statutit të IAL-së, miratuar me Urdhër nr. 90, datë 28.02.2017, Universiteti European i Tiranës (UET-i) në strukturën e tij akademike ka tre fakultete, si më poshtë:

1. **Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë** me këto departamente: Departamenti Financës dhe Ekonomiksit; Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut; Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Statistikës;
2. **Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit** me këto departamente: Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun; Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara; Departamenti i Edukimit;
3. **Fakulteti Juridik** me dy departamente dhe një qendër studimore:
 - Departamenti i së Drejtës Private, i cili ofron këto programe: Master i Shkencave “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me dy profilet: a) E Drejtë Private; b) E Drejtë Biznesi;
 - *Departamenti i së Drejtës Publike*, i cili ofron këto programe: Master i Shkencave “E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare”, me tre profilet: a) E Drejtë Penale; b) E Drejtë Publike dhe Kushtetuese c) E Drejtë Ndërkombëtare dhe Europiane dhe *Master Profesional në “Drejtësi”, me tre profile: a) E drejtë administrative; b) E drejtë ndërkombëtare dhe c) E drejtë evropiane;*
 - Qendra e Studimeve Ligjore “Ligji, Norma, Tradita”, në funksion të mësimdhënies: hartimit dhe përditësimit të programeve të studimit, organizimit të leksioneve të hapura, organizimit të aktiviteteve shkencore që thellojnë tematika të trajtuara në leksione (klube studentore, gjyqe imituese).

Në bazë të nenit 14.2 të Statutit të IAL, Fakulteti “është njësi kryesore, që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura”. Dekani është autoriteti drejtues kryesor i fakultetit dhe përfaqësues i tij (neni 20.4 i Statutit). Gjatë vizitës në IAL, Fakulteti i Drejtësisë sapo kishte zgjedhur Dekanin e ri me titull akademik Prof. Dr. Në bazë të nenit 14.2 të Statutit, Fakulteti “miraton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi”. Këto kritere janë miratuar në Rregulloren e Programit të Studimit Master në “Drejtësi”, me profile miratuar me vendim të Senatit akademik (neni 2 i Rregullores).




Në bazë të nenit 15 të Statutit të IAL-së, departamentet dhe qendrat kërkimore-shkencore konsiderohen si njësi bazë të mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore. Në bazë të nenit 15.2.2 “Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtare, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë”. Në bazë të nenit 15.3.1, qendra kërkimore shkencore “ka në përbërje të saj të paktën shtatë anëtare, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë”.

Neni 8.2.3 i Rregullores së IAL (miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 20.09.2011 të Senatit Akademik) përcakton se “Këshilli i Fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës, i cili përbëhet nga Dekani, Përgjegjësit e Departamenteve, Përgjegjësi i Qendrës së Kërkimit dhe të Zhvillimit, Kryetarët e Komiteteve Shkencore të Masterit, Koordinatorët e Programeve të Doktoratës dhe Kryetari i Këshillit Studentor të Fakultetit”. Gjithashtu, “Këshilli i Departamentit është organ konsultativ, i cili përbëhet nga përgjegjësi i departamentit, përgjegjësit e grup-lëndëve dhe personeli me titull “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar”, anëtarë të Departamentit”. Neni 8.2.7 i Rregullores së IAL përcakton se Këshilli Drejtues i Shkollës së Studimeve Master “është përgjegjës për administrimin e programeve të studimit të ciklit të dytë të studimeve” dhe drejtohet nga Drejtori i Shkollës Master (neni 9.1.6 i Rregullores së IAL). Sipas Strukturës Organizative të UET (2016-2017) zyra e programeve master dhe drejtori janë në varësi të Rektorit dhe rektoratit. Neni 8.2.8 i Rregullores përcakton se “Komitetet Shkencore të Programeve Master janë përgjegjëse për organizimin, drejtimin dhe administrimin e programeve master brenda departamenteve përkatëse. Koordinator i Komitetit shkencor është Përgjegjësi i Departamentit”, i cili në të njëjtën kohë është dhe autoriteti kryesor drejtues i Departamentit (neni 9.1.7 i Rregullores së IAL). Sipas nenit 10 të Rregullores, personeli akademik përbëhet nga të punësuar me kohë të plotë (drejtuesit, personel i brendshëm dhe pedagogë ‘senior’) dhe me kohë të pjesshme (personel i jashtëm, profesorë ‘emeritus’ dhe lektorë).

Programi i studimit Master Profesional në “Drejtësi”, me profile, funksionon mbi bazën e një organizimi disa-shtresash, që ndoshta mund të sjellë edhe pështjellime në kryerjen e detyrave të njësisive. Kështu, ndërsa Komitetet shkencore të programeve master janë përgjegjëse për programet përkatëse brenda departamenteve, Këshilli drejtues i shkollës së studimeve master është një organ me shtrirje horizontale në departamentet dhe fakultetet përkatës. Ky këshill drejtohet nga Drejtori i Shkollës Master. Po aq, pozicioni i Koordinatorit të programeve master mund të sjellë ndonjë paqartësi me atë të Drejtorit të Shkollës Master. Në rast vlerësimi të këtij qëmtimi, IAL-së i sugjerohet të reflektojë në dokumentacionin përkatës një qartësi më të madhe.

Sipas RVB (fq. 17) në UET ka ardhur duke u forcuar roli koordinues në nivel fakulteti, si dhe u fuqizua roli i departamenteve [...]; u forcua roli i grup-lëndës si qeliza më e vogël e kompetencës akademike [...].

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit si dhe struktura akademike

Siç është paraqitur dhe në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB, fq. 17) si dhe sipas informacionit të marrë gjatë vizitës në IAL (takimi me Dekanin e Fakultetit, drejtuesen e Qendrës, dhe Përgjegjësin e (ngarkuar) të Departamentit) Fakulteti Juridik ka në përbërje të tij



dy Departamente dhe një Qendër. Për vitin 2017-2018 Departamenti i së Drejtës Publike kishte në përbërje të tij 10 anëtarë të personelit akademik efektiv (PAE) prej të cilëve një me titullin Profesor i Asocuar (Prof. Asoc.), gjashtë me gradën Doktor (Dr ose PhD) dhe tre me gradën Master Shkencor (MSc). Të tre anëtarët e personelit akademik me kontratë (PAK) të angazhuar për vitin akademik 2017-2018 zotërojnë gradën Dr ose PhD, duke qenë një hap cilësor krahasuar me vitin akademik 2016-2017. Në krahasim me vitin 2016-2017, gjendja e stafit akademik efektiv të Departamentit të së Drejtës Publike paraqitet përgjithësisht e qëndrueshme me përjashtim të largimit të një anëtari të PAE me titullin Profesor (Prof.), dy PAE me gradën Doktor dhe një doktoranti, që bëjnë rreth 16% të personelit PAE të larguar. (Shih të dhënat në Tabelën 1 dhe 2).

Gjatë vizitës në institucion u konstatua se një anëtare e PAE (Përgjegjësjë e Departamentit të së Drejtës Publike) ndodhej në sabbatical për 6 muaj dhe një anëtar tjetër ndodhej për periudhë kërkimore në një universitet jashtë vendit për një vit. Detyrat e përgjegjësit të Departamentit të së Drejtës Publike ushtrohen nga Përgjegjësi i Departamentit të së Drejtës Private, me Urdhër Administrativ të Rektorit, datë 01.02.2018.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>IAL ka në përbërje të tij tre Fakultete nga të cilët, Fakulteti Juridik ka në përbërje tre njësi, përkatësisht Departamentin e së Drejtës Publike, Departamentin e së Drejtës Private dhe Qendrën “Ligji, Norma dhe Tradita”, të gjitha me objektiva dhe misione të përcaktuara qartë.</p> <p>Ndër vite, Departamenti i së Drejtës Publike ka pasur dhe vazhdon të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë, nga të cilët më shumë se tre kanë qenë me gradën shkencore Doktor.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe</p>	<p>Bazuar në nenin 15 të Statutit të IAL, departamentet dhe qendrat kërkimore-shkencore konsiderohen si njësi bazë të mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore. Departamenti koordinon, zhvillon dhe administron mësimdhënien dhe veprimtarinë kërkimore. Grup-lënda dhe përgjegjësi përkatës ka një rol të rëndësishëm në veprimtarinë e</p>

<p>në vlerësimin e tij.</p>	<p>mësimdhënies.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit është anëtar i komisionit përzgjedhës gjatë procesit të rekrutimit të personelit akademik, sikurse edhe anëtarë të tjerë nga Fakulteti Juridik i UET.</p> <p>Përveç këtyre njërive bazë, Statuti i IAL përcakton dhe institucione me shtrirje horizontale të cilët mund të kenë një rol në programin e studimit. Këshilli drejtues i shkollës së studimeve master (drejtohet nga Drejtori i Shkollës Master) është organ që përfshin disa departamente dhe fakultete. Programi master ka edhe një koordinator, roli i të cilit duket se është e nevojshme të qartësohet më tej. Departamenti, sipas akteve të brendshme të IAL-së, ka dhe Komitetin shkencor të programit master si përgjegjëse për programin brenda departamenteve. Konsideruar se ka edhe Këshill edhe Komitetet Shkencor, sugjerohet një qartësi më e madhe e roleve të tyre.</p>
-----------------------------	--

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Departamenti i së Drejtës Publike organizohet në përputhje me kërkesat ligjore, për rrjedhojë **standardi II.2 plotësohet.**
2. Njësitë bazë përfshihen në realizimin e mësimdhënies si dhe rekrutimin e stafit të ri akademik, **për rrjedhojë standardi II.3 plotësohet.**
3. Në bazë të Statutit dhe Rregullores së IAL-së, kuadri institucional është i plotë. Megjithatë, **rekomandohet që të qartësohet edhe më tej pozicioni i Drejtorit të Shkollës master në raport me koordinatoria e programeve master dhe i Komitetit Shkencor me atë të Këshillit Drejtuese të programit master.**

GVJ konkludon se standardet e lidhura me rubrikën 2 “Struktura Akademike e Fakultetit” plotësohen plotësisht, me rekomandimet sa më sipër.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Për realizimin e programit të studimit, Institucioni ka angazhuar një staf akademik të përbërë me personel efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Në total Fakulteti Juridik ka 28 PAE dhe 9 PAK për vitin akademik 2017-2018, në total 37 PA. Nga këta 19 PAE janë me tituj/grada shkencore dhe 5 PAK janë të tillë. (shih tabela nr. 1). Për programin e studimit Master Profesional, me profile, për vitin akademik 2017-2018 nga ana e institucionit janë angazhuar në raportin PAE/PAK 6:1, Profesorë në raportin 1:0, Prof.Asoc 1:0 dhe Doktorë/PhD 4:1 (shih tabela nr.3). Nga këta, 5 anëtarë PAE janë të Departamentit të së Drejtës Publike si dhe 1 anëtar PAE nga Departamente të tjera të UET si dhe 1 anëtarë PAK (tabela nr. 3). Për sa i

përket raportit midis gjinive, për programin e studimit, rezulton se anëtarë PAE janë 4 anëtare femra dhe 2 anëtar meshkuj (*shih tabela nr.3*), ndërsa nga anëtarët PAK, 1 anëtare femër. Për sa i përket moshës, me titull profesor është 1 PAE i grup-moshës 56-65 vjeç, një Profesor i Asoc. i grup-moshës 36-45, dhe Dr/PhD janë 4 nga të cilët 2 të grup-moshës 25-35 dhe 2 të grup-moshës 36-45. Nga PAK me gradë shkencore Dr/PhD është 1 i grup-moshës 36-45 (*shih tabela nr. 5*).

Të dhënat në lidhje me përbërjen e stafit dhe titujt akademik dhe gradat shkencore për vitet 2011-2018 pasqyrohen në mënyrë të detajuar në Aneksat e këtij raporti.

Po ashtu, GVJ verifikoi dosjet e personelit të personave të angazhuar si PAE dhe PAK në këtë program studimi, dosje të cilat rezultojnë të plota. Nga verifikimi dhe konstatimet në institucion rezulton se të gjithë anëtarët kanë kontrata të rregullta dhe të plota, edhe pse ka pasur fillimisht kontrata shërbimi të diferencuara për PAK me angazhime vjetore të përcaktuara përgjithshëm në kontratë. Personeli rezulton se njeh të drejtat dhe detyrimet e veta.

Personeli administrativ në UET është në funksion të të gjithë universitetit. Për vitin akademik 2017-2018 numri i personelit administrativ është 52. (*shih tabela nr. 1*).

Ky personel mbështet nëpërmjet veprimtarisë teknike, administrative dhe materiale, stafin akademik, si edhe mirëfunksionimin e shërbimeve të tjera në këtë institucion.

Ngarkesa e personelit akademik të UET-it përfshin ngarkesën në veprimtarinë mësimdhënëse, në veprimtarinë shkencore, si dhe në angazhime të tjera administrative. Pjesë e ngarkesës janë dhe veprimtaritë në kualifikimin e vazhdueshëm profesional.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit

Fakulteti Juridik është një ndër tre Fakultetet e Universitetit Europian të Tiranës dhe në përbërje të tij janë dy Departamente dhe një Qendër, konkretisht: Departamenti i së Drejtës Publike, Departamenti i së Drejtës Private dhe Qendra e Studimeve "Ligji, Norma, Tradita".

Departamentet kanë në përbërjen e tyre disa grup-lëndësh. Në Departamentin e së Drejtës Publike bën pjesë dhe programi i studimit Master Profesional në "Drejtësi", me profile: a. E drejtë administrative; b. E drejtë ndërkombëtare dhe c. E drejtë evropiane.

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat

Siç u theksua më lart, për programin e studimit Master Profesional në "Drejtësi", me profile: a. E drejtë administrative; b. E drejtë ndërkombëtare dhe c. E drejtë evropiane, për vitin akademik 2017-2018 nga ana e Institucionit janë angazhuar 5 anëtarë PAE të Departamentit të së Drejtës Publike si dhe 1 anëtar PAE nga Departamente të tjera UET si dhe 1 anëtar PAK. Grupi i vlerësimit të jashtëm gjatë vizitës në institucion kontaktoi me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi për periudhën e vlerësimit (2011-2018). Të dhënat lidhur me këtë personel gjenden në Tabela 3 bashkëlidhur. Nga të dhënat e dokumentacionit rezulton:

- Personeli akademik efektiv për vitin akademik 2011-2012 përbëhej nga: 4 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët 2 janë pjesë e Departamentit të së Drejtës Publike (ku është i organizuar ky program studimi) dhe 2 janë pjesë e strukturave të tjera të UET; nga

personeli PAE 3 kanë gradën shkencore “Doktor”/PhD, dhe 1 LLM. Personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhej nga 2 pedagogë, 1 Prof.Dr dhe 1 Dr. (Tabela 3/2011-2012).

- Personeli akademik efektiv për vitin akademik 2012-2013 përbëhej nga: 7 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët 4 janë pjesë e Departamentit të së Drejtës Publike (ku është i organizuar ky program studimi) dhe 3 janë pjesë e Departamenteve të tjera të UET; nga personeli PAE kanë titullin akademik: 1 Prof.Dr, 1 Prof.Asoc, 3 PhD/Dr dhe 2 Doktorantë. Personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhej nga 2 pedagogë, 1 Prof.Dr dhe 1 Dr. (Tabela 3/2012-2013).
- Personeli akademik efektiv për vitin akademik 2013-2014 përbëhej nga: 5 pedagogë efektivë (PAE) të gjithë pjesë e Departamentit të së Drejtës Publike (ku është i organizuar ky program studimi); nga personeli PAE 1 ka titullin akademik Prof.Dr, 1 Prof.Asoc., 1 Dr /PhD dhe 2 Doktorantë. Personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhej nga 1 Prof.Dr. (Tabela 3/2013-2014).
- Personeli akademik efektiv për vitin akademik 2014-2015 përbëhej nga: 6 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët 5 janë pjesë e Departamentit të së Drejtës Publike (ku është i organizuar ky program studimi) dhe 1 pjesë e Departamenteve të tjera të UET; nga personeli PAE kanë titullin akademik 1 Prof.Dr, 1 Prof.Asoc, 2 PhD dhe 2 Doktorantë. Personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhej nga 3 pedagogë, 2 Prof.Asoc. dhe 1 Dr. (Tabela 3/2014-2015).
- Personeli akademik efektiv për vitin akademik 2015-2016 përbëhej nga: 6 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët 5 janë pjesë e Departamentit të së Drejtës Publike (ku është i organizuar ky program studimi) dhe 1 pjesë e Departamenteve të tjera të UET; nga personeli PAE kanë titullin akademik 1 Prof.Dr, 2 Prof.Asoc, 2 Dr/PhD dhe 1 Doktorant. Personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhej nga 2 pedagogë, 1 Prof.Asoc. dhe 1 Dr. (Tabela 3/2015-2016).
- Personeli akademik efektiv për vitin akademik 2016-2017 përbëhej nga: 10 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët 8 janë pjesë e Departamentit të së Drejtës Publike (ku është i organizuar ky program studimi) dhe 2 pjesë e Departamenteve të tjera të UET; nga personeli PAE 2 kanë titullin akademik Prof.Dr, 1 Prof.Asoc., dhe 7 Dr/PhD. Personel akademik me kontratë (PAK) nuk ka këtë vit. (Tabela 3/2016-2017).
- Personeli akademik efektiv për vitin akademik 2017-2018 përbëhet nga: 6 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët 5 janë pjesë e Departamentit të së Drejtës Publike (ku është i organizuar ky program studimi) dhe 1 pjesë e Departamenteve të tjera të UET; nga personeli PAE 1 ka titullin akademik Prof.Dr, 1 Prof.Asoc., 4 Dr/PhD. Personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhet nga 1 pedagog me PhD. (Tabela 3/2017-2018).

Nga të dhënat e administruara në institucion, rezulton se personeli akademik i aktivizuar në këtë program studimi, është i aktivizuar në programin e studimit Master Profesional që mbulohet nga Departamenti i së Drejtës Publike, por edhe programe të tjera të Fakultetit Juridik apo të tjera të UET. Ky personel është i përshtatshëm dhe përgjithësisht i qëndrueshëm në program. Duke e ndarë personelin akademik sipas lëndëve, sipas "Aneks/ Shtojcë Plani mësimor i lidhur me personelin akademik të Master Profesional në “Drejtësi” me profile rezulton se:

- personeli akademik efektiv për vitin akademik 2011-2012 është i angazhuar në 5 lëndë, ndërsa personeli akademik me kontratë është i angazhuar në 3 lëndë.
- personeli akademik efektiv për vitin akademik 2012-2013 është i angazhuar në 10 lëndë, ndërsa personeli akademik me kontratë është i angazhuar në 4 lëndë.
- personeli akademik efektiv për vitin akademik 2013-2014 është i angazhuar në 8 lëndë, ndërsa personeli akademik me kontratë është i angazhuar në 2 lëndë.
- personeli akademik efektiv për vitin akademik 2014-2015 është i angazhuar në 8 lëndë, ndërsa personeli akademik me kontratë është i angazhuar në 3 lëndë.
- personeli akademik efektiv për vitin akademik 2015-2016 është i angazhuar në 10 lëndë, ndërsa personeli akademik me kontratë është i angazhuar në 2 lëndë.
- personeli akademik efektiv për vitin akademik 2016-2017 është i angazhuar në 10 lëndë, ndërsa personeli akademik me kontratë në 0 lëndë.
- personeli akademik efektiv për vitin akademik 2017-2018 është i angazhuar në 9 lëndë, ndërsa personeli akademik në 1 lëndë.

Raporti i ngarkesës mësimore PAE/PAK rezulton:

- Viti akademik 2011-2012: 62.5%/37.5%
- Viti akademik 2012-2013: 71%/29%
- Viti akademik 2013-2014: 80%/20%
- Viti akademik 2014-2015: 73%/27%
- Viti akademik 2015-2016: 83%/17%
- Viti akademik 2016-2017: 100%/0%
- Viti akademik 2017-2018: 90%/10%

Në lidhje me ngarkesën konkrete mësimore, referojuni tabelave 10/1-2-3-4-5-6-7 bashkëlidhje e këtij raporti.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit

Në këshillin shkencor të Departamentit të së Drejtës Publike bëjnë pjesë:

1. Prof.As. Dr Erjona Canaj, Kryetare
2. PhD. Ledina Shkurti, Anëtare
3. PhD. Evelina Çela, Anëtare (*shih Tabela nr. 4*).

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Në të gjitha vitet akademike pjesa më e madhe e pedagogëve kanë qenë me tituj e grada shkencore (ose në proces), vetëm gjatë vitit akademik 2011-2012 ka patur një personel me LLM, si vijon:

- Viti akademik 2011-2012: 4 Dr/PhD, dhe 1 LLM
- Viti akademik 2012-2013: 2 Prof.Dr, 1 Prof.Asoc, 4 PhD/Dr dhe 2 Doktorantë

- Viti akademik 2013-2014: 2 Prof.Dr, 1 Prof.Asoc., 1 Dr/PhD dhe 2 Doktorantë
- Viti akademik 2014-2015: 1 Prof.Dr, 3 Prof.Asoc, 3 PhD/Dr dhe 2 Doktorantë
- Viti akademik 2015-2016: 1 Prof.Dr, 3 Prof.Asoc, 3Dr/PhD dhe 1 Doktorant
- Viti akademik 2016-2017: 2 Prof.Dr, 1 Prof.Asoc., dhe 7 Dr/PhD
- Viti akademik 2017-2018: 1 Prof.Dr, 1 Prof.Asoc., 5Dr/PhD

Kualifikimet e personelit akademik kanë qenë të mjaftueshme në tituj /grada për secilin vit akademik. Të dhënat sipas kualifikimit paraqiten në mënyrë të detajuar në Tabelën nr. 3 bashkëlidhur.

Të dhënat sipas seksit

Personeli akademik efektiv i programit, sipas gjinisë, Femra-Meshkuj, për vitet akademike, është paraqitur në Tabelat 3. Në vitet akademike 2011-2012 deri 2015-2016 përqindja e femrave ka variuar nga 16 % (2011-2012) deri 25% (2015-2016). Në vitin akademik 2016-2017 ka një ndryshim të plotë të kësaj përfaqësie me përfshirjen në masën 37% gjinia femërore dhe gjatë vitit akademik 2017-2018 ndryshimi është drastik, me 70% femra. Do të sugjerohet që edhe në respektim të Ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" të mbahej në konsideratë në vijimësi respektimi i kuotës të paktën 30% të një gjinie.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Personeli akademik sipas moshës është paraqitur në Tabelat 5 bashkëlidhur. Në programin e studimit Master Profesional në "Drejtësi" me profile, ka një shpërndarje të shëndetshme të brezave të personelit akademik:

- për vitin akademik 2016-2017 të dhënat tregojnë se:
 - PAE janë të moshës 25-35 vjeç 3 Dr/PhD; të moshës 36-45 vjeç 1 Prof. Asoc. dhe 1 Dr/PhD; të moshës 56-65 vjeç 1 Prof.Dr.; dhe të moshës 66-68 vjeç 1 Prof.Dr. (nuk ka asnjë PAK për këtë vit akademik).
- për vitin akademik 2017-2018 të dhënat tregojnë se:
 - PAE janë të moshës 25-35 vjeç 2 Dr/PhD; të moshës 36-45 vjeç 2 Dr/PhD, të moshës 36-45 vjeç 1 Prof.Asoc.; të moshës 56-65 vjeç 1 Prof.Dr.
 - PAK të moshës 36-45 vjeç: 1 Dr/PhD.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Nga verifikimi dhe konstatimet në institucion nga GVJ-ja gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore rezulton se kontratat e punës ishin të nënshkruara, në to ka të dhëna lidhur me të drejtat e detyrat e punonjësve, pra punonjësit njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre. Personeli ka lidhur kontrata të reja në vitin 2018, sipas një formati të ri të miratuar. GVJ-ja pa në Zyrën e Burimeve Njerëzore të IAL-së tre dosje të punonjësve efektivë dhe të jashtëm, të cilat rezultuan të plota. Në dy raste, me personel akademik me kontratë, u vu re përdorimi i kontratave të angazhimit me pagesë vjetore në vitet pararendëse, për të cilën GVJ sugjeroi të mos përsëriten me qëllim që kontratat të reflektojnë kërkesat e Kodit të Punës për paga periodike. Po ashtu,

GVJ-ja vuri re përdorimin në dy raste të kontratave të shërbimit për angazhimin e personelit të jashtëm, gjë që nuk ishte më rasti në kontratën e fundit, aktuale të lidhur me këtë personel: aktualisht përdoret kontrata e punës si model angazhimi të tyre. GVJ-ja nuk gjeti në dosje lejen për angazhim në IAL të personelit të jashtëm, por formati i vërtetimit të punës që u kërkohej atyre të sillnin ishte i tillë që linte të nënkuptohej se kjo leje ishte dhënë. Po ashtu, për personelin e jashtëm kontrata nuk specifikonte ngarkesën për të cilën ishte i angazhuar konkretisht ky personel, duke e lënë të paqartë fillimisht angazhimin konkret të tyre.

☑ Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Personeli administrativ në UET është në funksion të të gjithë universitetit. Për vitin akademik 2017-2018 numri i personelit administrativ është 52. (shih Tabela nr. 5).

Ky personel mbështet nëpërmjet veprimtarisë teknike, administrative dhe materiale, stafin akademik, si edhe mirëfunksionimin e shërbimeve të tjera në këtë institucion.

Ngarkesa e personelit akademik të UET-it përfshin ngarkesën në veprimtarinë mësimdhënëse, në veprimtarinë shkencore, si dhe në angazhime të tjera administrative. Pjesë e ngarkesës janë dhe veprimtaritë në kualifikimin e vazhdueshëm profesional. Puna e personelit, dhe jo vetëm atij administrativ, kontrollohet nga KSBC-ja e UET-së.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Institucioni rezulton se ka një personel të mjaftueshëm akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ që mundëson zhvillim normal të procesit të mësimdhënies si edhe realizimin e shërbimeve për studentët.</p> <p>Angazhimi i personelit akademik, ndihmës-mësimor shkencor dhe administrativ, është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit, si edhe me vizionin dhe misionin që ka UET. Personeli para fillimit të vitit akademik njihet me objektivat e programit të studimit si dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. Puna e tyre kontrollohet rregullisht nga KSBC që sugjeron përmirësimet e punës sipas strategjisë dhe akteve rregulluese.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të</p>	<p>Çdo anëtar i departamentit merr pjesë aktivisht në hartimin e kurrikulës dhe vendimet institucionale. Këto çështje diskutohen në njësinë bazë më së pari. Përgjegjësi i Departamentit dhe përgjegjësi i grup-</p>

<p>studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>lëndëve kanë si detyrë dhe hartimin e kurrikulës së programit të studimit. Për hartimin e programit të lëndëve janë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë stafi përkatës akademik. Propozimet që miratohen në nivel Departamenti, përcillen për miratim të mëtejshëm në organet eprore si Këshilli i Fakultetit dhe Senatit në vijim. I tillë ishte rasti edhe i ndryshimeve në kurrikul, në përputhje me legjislacionin, në programin Master Profesional në “Drejtësi”, me profile.</p> <p>Neni 44 i Statutit të UET përcakton se rekrutimi i personelit akademik bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit. Kriteret bazë përcaktohen nga njësia përgjegjëse dhe miratohen nga ana e Rektorit. Më pas është Rektori i cili ngre komisionin që zhvillon procedurën e konkurrimit. RVB-ja përcakton se Përgjegjësi i Departamentit është anëtar i këtij komisioni dhe kjo u verifikua edhe nga vizita e GVJ në institucion (Referuar takimit me Zyrën e Burimeve Njerëzore). Nga këto të dhëna rezulton se rekrutimi i personelit bëhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Statuti i UET përcakton dhe rregullon veprimtarinë e institucionit. Në të përcaktohen rregullat e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesshme.</p> <p>Nga vizita dhe takimet që GVJ zhvilloi në zyrën e personelit, rezultoi se rekrutimi i personelit akademik është në përputhje me këtë akt dhe rekrutimi i tij është transparent. Në UET shpalljet e nevojave bëhen para fillimit të vitit akademik, sipas nevojave që nxjerrin departamentet për staf të ri. Këto nevoja përcillen tek dekanati dhe Zyra e Burimeve Njerëzore dhe i bëhen me dije komisionit të vlerësimit që është i veçantë sipas departamenteve. Pasi bëhet shpallja, priten aplikimet, shqyrtohet dhe seleksionohen kandidatët për intervistë dhe njoftohen me e-mail. Komisioni intervistues përbëhet nga shefi i departamentit, rektori (me dëshirë edhe administratori) dhe ndonjë punonjës tjetër. Çdo anëtar vlerëson me pikë kandidatët dhe më pas merret vendimi final.</p>

	<p>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit Master Profesional në “Drejtësi”, me profile. Për tre vitet akademike të fundit raporti i ngarkesës mësimore PAE/PAK rezulton: viti akademik 2015-2016: 83%/17%; viti akademik 2016-2017: 100%/0%; dhe viti akademik 2017-2018: 90%/10%. Pra, raporti ndërmjet PAE dhe PAK lidhur me ngarkesën mësimore për vitet akademike është në përputhje me kërkesat e këtij standardi.</p> <p>Për sa i përket vlerësimit të personelit, Institucioni ndjek një procedurë vlerësimi për personelin akademik. Kjo procedurë përfshin vlerësim nga studentët; vlerësim nga përgjegjësi i departamentit; vlerësim nga dekani dhe drejtuesit e UET-së në përfundim të vitit akademik. Formulari i vlerësimit të stafit vlerëson performancën akademike në auditor të pedagogëve, respektimin e orarit mësimor (mbi baza kontrolli të rastësishëm), etj. Të gjitha këto të dhëna bëhen pjesë e një analize vjetore, e cila madje një periudhë kohe ishte bazë për mundësimin e përfitimit të një mbështetje financiare për zhvillimin akademik-personal të personelit, por që me modelin e kontratës së re nuk aplikohet më.</p> <p>Institucioni mban një bazë të plotë të të dhënave të raporteve të rekrutimit të personelit, si edhe të njoftimeve për punë dhe komunikimeve.</p>
--	---

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e</p>	<p>Përgjegjësi i programit të studimit Master Profesional në “Drejtësi”, me profile, ka titullin shkencor “Profesor i Asociuar” dhe ka eksperiencë të gjatë akademike. Është personel i punësuar me kohë të plotë (PAE).</p> <p>Titullarët e lëndëve në programin e studimit, për vitin akademik 2017-2018, janë 2 me titullin “Profesor”, 2 me titullin “Profesor i Asociuar”, 4 me gradën “PhD” dhe 2 me “Doktor”. Pra, të gjitha lëndët e kurrikulës së programit kanë titullarë kryesorë me të paktën gradë shkencore Dr. Në 9 lëndë titullarë lëndësh janë PAE, ndërsa në 1 është</p>
--	--

<p>studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>PAK.</p> <p>Rezulton nga CV-të se titullarët dhe pedagogët e lëndëve kanë përvojën profesionale të kërkuar në përgjithësi. Ka një rast të një pedagogu që angazhohet prej një viti në një lëndë të programit në të cilën nuk ka ekspertizë në referim të CV-së.</p> <p>Drejtimesit e njësive të institucionit janë të gjithë personel i punësuar me kohë të plotë (PAE).</p> <p>Lidhur me praktikën profesionale, Institucioni i ofron studentit mundësinë për të zgjedhur vetë vendin e realizimit të praktikës profesionale. Praktika profesionale nuk zhvillohet në mënyrë të përqendruar në disa institucione, por secili student e zhvillon atë më vete sipas komunikimeve që studenti i mundëson kryesisht vetë. Sipas dokumentacionit të administruar gjatë vizitës në institucion rezulton se si pedagog mbikëqyrës është vetëm një për të gjithë institucionin. <i>Duke pasur në konsideratë numrin e studentëve si edhe standardet shtetërore, rezulton se ky kriter nuk plotësohet plotësisht.</i></p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Nga RVB (fq.26) dhe nga verifikimi në institucion (intervista me personelin akademik dhe me studentët si dhe shqyrtimi i dokumentacionit si dhe i sondazheve) rezulton se studentët që në fillim parashtrajnë fushën në të cilën do të realizojnë tezën për marrjen e diplomës. Studentët sqaruan edhe se tezat zhvillohen përmes seancave metodologjike në ndihmë të procesit të shkruarit të temës, përfshirë identifikimin e pyetjes kërkimore, metodologjisë, strukturës, etj. (10 të tilla). Për çdo student sigurohet pedagogu udhëheqës. Në referim edhe të të dhënave për personelin akademik në këtë program studimi, pedagogu udhëheqës ka gradë ose titull akademik. Sikurse reflektohet edhe në RVB (fq.26) pedagogët udhëheqës të temave mbikëqyrin jo më shumë se 10 studentë.</p> <p>Koordinatorja e departamentit si dhe Sekretaria e institucionit mban të dhënat për temat e diplomave, udhëheqësit si dhe pikët për secilën diplomë.</p>

Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.

<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p>	<p>Temat janë brenda fushës studimore-kërkimore që ofron programi i studimit dhe udhëheqësit kanë njohuri të avancuara dhe të thelluara për zhvillimin e kërkimit dhe hartimin e tezës për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	

Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p>	<p>Nisur nga natyra e këtij programi studimi, rezulton se nga ana e institucionit, është vënë në dispozicion personel ndihmës mësimor-shkencor, përfshirë personelin e bibliotekës së Universitetit, sekretarinë mësimore (e cila gjatë vizitës nga GVJ-ja shfaq kompetencë të plotë në kryerjen e detyrës), si edhe punonjës IT. Edhe mirëmbajtja e ambienteve në dispozicion të programit realizohet nga personeli përkatës.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Në institucionin rezulton se ka një personel akademik dhe ndihmës akademik i cili mundëson zhvillim optimal të procesit të mësimdhënies si edhe realizimin e shërbimeve në favor të studentëve.</p>

Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p>	<p>Sipas dokumentit të ngarkesës në auditor të përgatitur nga IAL, kërkuar nga GVJ-ja, rezulton se secili nga pedagogët e realizon ngarkesën e parashikuar në aktet ligjore e nënligjore. Për vitin akademik 2016-2017, PAE ka mbuluar 100% të ngarkesës mësimore në auditor për këtë program studimi (Msc), ndërsa për vitin 2017-2018 PAK ka mbuluar vetëm 52.5 orë në auditor dhe PAE ka mbuluar 896 orë në auditor ngarkesës së lëndëve në këtë program studimi. (Tabelë e kërkuar gjatë vizitës së GVJ në IAL).</p>
<p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Lidhur me ngarkesën e përgjithshme të stafit në</p>

	<p>orë në auditor dhe lëndë, për vitin akademik 2017-2018, stafi PAE ka mbuluar përkatësisht: 1 pedagog 2 lëndë, 3 pedagogë 3 lëndë dhe 2 pedagogë 4 lëndë, ndërsa stafi PAK ka mbuluar 1 pedagog 1 lëndë. Ngarkesa në orë në auditor për pedagog paraqitet nga 52.5 deri në 196 orë.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Nga verifikimi në Zyrën e Burimeve Njerëzore, rezultoi se kjo e fundit disponon një bazë të hollësishme të dhënash për anëtarët e personelit akademik: ata kishin dosjen e tyre personale në të cilën gjendeshin: Kërkesa për t'u punësuar në UET, Dokumenti i identitetit, Libreza e punës, Libreza e kontributeve të sigurimeve shoqërore, Libreza shëndetësore, Diploma Universitare përfshirë edhe dëshminë e njohjes së diplomës; (jo në të gjitha rastet gjendej lista e notave), Diploma dhe dokumente të tjera të gradave dhe titujve shkencorë si dhe të kualifikimeve të tjera, CV, Kontratat e lidhura përgjatë viteve të punës UET (për PAE kontratat e reja të lidhura me afat të pacaktuar), Vlerësimet nga studentët, kolegët dhe përgjegjësi i departamentit, Të dhëna për llogarinë bankare.</p> <p>Nga RVB si edhe nga verifikimi në institucion, Departament dhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore rezulton se Fakulteti dhe njësitë bazë disponojnë listën e plotë të personelit akademik.</p> <p>Nga verifikimi i praktikave të punësimit në Institucion, rezulton ky Institucion përcakton kriteret të përgjithshme për rekrutimin e personelit akademik në fillim të viti (GVJ-ja pa modelet e njoftimit sipas të cilave bëhet thirrje për angazhim pranë UET në përgjithësi pa specifikuar departamentin apo fushën ku kjo IAL ka nevoja, edhe pse nevojat identifikoheshin nga departamentet dhe i transmetoheshin zyrës së burimeve njerëzore dhe rektoratit). UET i publikon thirrjet e rekrutimit të personelit akademik në median e shkruar dhe elektronike.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>1. GVJ vlerëson se personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohet për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve plotësohet, për rrjedhojë standardi II.1 plotësohet;</p>	

2. GVJ vlerëson se personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit, **për rrjedhojë standardi II.4 plotësohet;**
3. GVJ-ja vlerëson se institucioni ndjek procedura transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit, por thirrjet për rekrutim janë të përgjithshme dhe jo të specifikuar sipas nevojave të programit të studimit, **për rrjedhojë standardi III.1 plotësohet kryesisht me sugjerimin** që në vijim të tilla thirrje të përcaktojnë qartë fushën në të cilën nevojitet personeli akademik.
4. Personeli akademik me grada shkencore dhe tituj akademikë mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë, **për rrjedhojë standardi III.2 plotësohet kryesisht, me përjashtim të Kriterit 5 lidhur me sigurimin e personelit të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale;**
5. Studentët që ndjekin programin Master Profesional kanë udhëheqës për tezën dhe fusha studimore e udhëheqësve përputhet me atë të programit Master Profesional në Drejtësi me profile, **për rrjedhojë standardi III.5 dhe III.6 plotësohen;**
6. Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të programit Master Profesional në Drejtësi me profile, **për rrjedhojë standardi III.7 plotësohet;**
7. Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar sipas programit të Master Profesional në Drejtësi me profile në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, **për rrjedhojë standardi III.8 plotësohet;**
8. Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e angazhuar në programin Master Profesional në Drejtësi me profile, **për rrjedhojë standardi III.9 plotësohet,** me **sugjerimin** që të përfshihet në dosjet e personelit edhe dokumentet të tjerë si p.sh. lista e notave.

GVJ konkludon se standardet e lidhura me rubrikën 3 “Personeli akademik dhe personeli mbështetës” plotësohen plotësisht me sugjerimet si më sipër.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

RVB ka paraqitur situatën e infrastrukturës në funksion të programit të studimit, logjistikën dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit (fq. 28-32). RVB jep një panoramë të përgjithshme të infrastrukturës, duke mos përcaktuar se cila nga këto ambiente është në funksion të dedikuar të Programit të Studimit Master Profesional me profile, por nga takimet në institucion dhe ato me stafin, u informuam se nuk ka ambiente të dedikuara për këtë program, ndaj shfrytëzohen të gjitha ambientet e IAL, në ditët e përcaktuara (ditët e premtë pasdite dhe ditët e shtuna paradite) për këtë program, kjo duke marrë në konsideratë edhe mundësitë e studentëve për të frekuentuar.

IAL ka në dispozicion tre godina – përfshirë edhe bibliotekën. Sipërfaqja totale e godinave të Universitetit së bashku me ambientet e tjera është rreth 10,000 m², prej të cilave:

- Godina A është e përbërë nga 4 kate, (çdo kat ka një sipërfaqe rreth 1000 m2);
- Godina B është e përbërë nga 4 kate, (çdo kat ka një sipërfaqe rreth 1000 m2);
- Godina C (biblioteka) gjithsej 300 m2
- Ambiente të tjera shërbimi (parkim, kafene, etj).

Sipërfaqet ndahen në salla leksionesh, salla seminaresh, salla laboratorësh, salla interneti, biblioteka, salla për departamentet, drejtuesit e institucionit, etj. Sallat e leksioneve dhe seminareve ishin komode për një kohëzgjatje normale të procesit mësimor, të pajisura me tabela për të shkruar, me projektorë, dhe në kushte të përshtatshme ndriçimi. Në sallat që janë me pamje nga lumi Lana dhe rruga kryesore, zhurmat, nëse mbahen dritaret hapur sidomos, janë shqetësuese dhe potencialisht ndikojnë në cilësinë e procesit mësimor - *në këtë kontekst sugjerohet që në të ardhmen të mundësohet (brenda mundësive të IAL) një izolim akustik në mënyrë që kjo kategori sallash të jetë e përshtatshme për procesin e mësimdhënies.*

Gjatë vizitës në IAL, u vizitua Biblioteka, zyra e burimeve njerëzore, zyra e sekretares së përgjithshme, zyra e koordinatores së programeve master, zyrat e pedagogëve, si dhe një ambientet e mbledhjeve ku u zhvilluan takimet, dhe rezultoi se ishin në kushte mjaft të përshtatshme pune, në përputhje edhe me përshkrimet në RVB.

Biblioteka është ngritur në nivel IAL dhe gjendet në godinën C (një ambient i dedikuar në katin e parë që krijon akses për të gjithë studentët dhe pedagogët, përfshirë edhe persona që mund të jenë me aftësi të kufizuara). Ajo vë në dispozicion të studentëve ambiente leximi dhe ambiente për përdorimin e kompjuterëve - sipas RVB raportohen 150 vende leximi, fq. 28, ndërkohë që nga vizita në terren na rezultoi një kapacitet prej afro 100 vendesh. Gjithsesi Biblioteka kishte vend dhe hapësirë të mjaftueshme për të akomoduar edhe tej këtij kapaciteti studentë që mund të dëshirojnë të lexojnë aty. Ndërkohë që vetëm një numër i kufizuar i tavolinave në sallë ishte pajisur me kompjuterë, tavolinat e tjera ishin të përshtatshme për të lexuar në sallë. Një gjë e tillë nuk përbën problem të pa-kapërcyeshëm pasi studentët e këtij programi na informuan se sekretaria dhe koordinatori i programit, por edhe vetë Biblioteka u mundëson atyre që të aksesojnë online nëpërmjet një llogarie personale materiale që u shërbejnë për studimet. *Në të ardhmen do të sugjerohet që në varësi të mundësive financiare të mund të shtohet numri i kompjuterave në mënyrë që studentët të mund të aksesojnë materiale online edhe në ambientet e IAL/Bibliotekës.*

Pasurimi i bibliotekës me tituj të rinj bëhet sipas kërkesave që paraqiten nga çdo njësi bazë e IAL-së dhe shfrytëzohet mundësia e blerjes së librave të rinj gjatë zhvillimit të panairit kombëtar të librit që zhvillohet çdo vit. Një tjetër aspekt pozitiv është që nga ana e IAL bëhen dhe përkthime të teksteve të huaja në gjuhën shqipe, të cilat bëhen pjesë e fondit të bibliotekës. Biblioteka dispononte gjithashtu edhe fondin e librave. Sipas RVB (fq. 30), pasurimi i fondit të bibliotekës bëhet nëpërmjet: blerjes në fillim të çdo vit akademik të teksteve universitare; blerjes në panairin e librit të botimeve që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me procesin mësimor; përkthimit dhe botimit të teksteve universitare nga UET Press; përmes porosive dhe blerjeve online të teksteve në gjuhën angleze, si dhe përmes dhurimeve nga organizata, ambasada, individë, fondacione. Tekstet e programit i cili kërkohet të akreditohet gjendeshin në Bibliotekë, të tilla si *Të drejtat e njeriut: Debati dhe Jurisprudenca, E drejta e migracionit dhe refugjatit, Studime të avancuara në të drejtë europiane*, të cilët nga takimi me studentët na rezultoi se librat e caktuar në syllabus si literaturë e detyrueshme për lëndët gjenden lehtësisht në Bibliotekë, por një pjesë e studentëve kishin zgjedhur t'i blinin tekstet për ti pasur në

bibliotekën e tyre edhe pas përfundimit të studimeve, ndërkohë që një pjesë e materialeve mund të fotokopjohen.

Veç literaturës fizike, biblioteka shërben edhe nëpërmjet Bibliotekës elektronike (*e-library Sage ose Ebsco*); kjo mundëson akses në disiplina që lidhen me programin e studimit në të drejtën administrative, të drejtë evropiane dhe të drejtë ndërkombëtare, raste nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë të SHBA. Sage mundëson gjithashtu akses në revista akademike prestigjioze që kanë rëndësi për programin e studimit: *Maastricht Journal of European and Comparative Law, International Journal of Discrimination and the Law, Netherlands Quarterly of Human Rights*, etj. Nga biseda me studentët, u informuam se ju dërgohen e-mail me informacione mbi ekzistencën e këtyre burimeve elektronike. RVB përmend se IAL ka kryer abonime në bibliotekat online me një afat pesë vjeçar, gjë që u konfirmua edhe nga punonjësit e bibliotekës. Gjithashtu, nga vizita në ambientet e Bibliotekës, rezultoi që aksesimi i burimeve online të revistave apo librave në fondin e librave elektronikë ishte pak e vështirë për studentin, ndaj *do të sugjerohet që stafi i Bibliotekës në bashkëpunim me pedagogët e profilit të hartojnë një broshurë/booklet të përmbledhur informative në dispozicion të studentëve për lehtësi aksesit të materialeve online*. Gjithashtu nga vizita në Bibliotekë u informuam se punonjësit e saj, kohë pas kohe kanë shkarkuar materiale në formatin PDF (revista, libra, prezantime) duke krijuar një **'katalog elektronik'** për secilën disiplinë dhe profil, të cilën ua venë në dispozicion studentëve sipas kërkesës.

Gjatë bisedave me stafin por dhe me studentët e programit, u konstatua se IAL përdor sistemin LMS (RVB fq. 29). Ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të përditësohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shpesh audio vizive etj. duke përdorur teknikën mjaft të avancuar për e-learning MOODLE, si dhe mundëson njoftimet e studentëve lidhur me procesin mësimor, aktivitetet shkencore, social-kulturore, vlerësimet e tyre si dhe një sërë komunikimesh të tjera.

Lidhur me infrastrukturën, vlen të përmendet edhe hapësira e bollshme e parkimit të IAL në funksion të stafit pedagogjik, administratës dhe studentëve si në pjesën përpara godinës (hyrjes qendrore) ashtu edhe në pjesën e pasme. Gjithashtu, vlen të theksohet se në ambientet e IAL - UET, në funksion të programit të studimit për të cilin kërkohet akreditim (Master Profesional me Profile - E Drejtë Administrative, Evropiane dhe Ndërkombëtare) janë edhe ambientet e kafe/bar dhe mensës, një komoditet për të gjithë personat që studiojnë dhe punojnë në IAL - kushtet e tyre janë të përshtatshme dhe përveç shërbimeve ofrojnë edhe një mundësi të mirë për socializim të studentëve. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ-ja u vu re një volum i lartë i muzikës në këto ambiente; në këto kushte, bazuar edhe tek eksperiencia e këtyre lloj ambienteve të shërbimeve në Universitete me reputacion ndërkombëtar që janë të qeta ose me nivel minimal muzike, *do të sugjerohet që të konsiderohet kjo praktikë e mirë për ofrimin e shërbimeve në bar/kafe dhe mensë me një nivel të ulët muzike në sfond, e përshtatshme edhe me misionin e IAL*.

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale

- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qendrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- ✓ Inventari i librave për Fakultetin Juridik

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p>	<p>IAL ka një vendndodhje të përhershme mjaft të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. UET zhvillon veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe administrative në të njëjtin ambient për shumë vite me radhë (që kë krijimin e tij). Ky fakt dëshmon për qëndrueshmëri të infrastrukturës.</p> <p>IAL ka ambiente të ndryshme si salla mbledhjesh/eventesh, zyra (Rektori, burimet njerëzore, koordinatori i programit master), bibliotekën, si dhe ambiente të përbashkëta.</p>

<p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Drejtësi me profile ofrohet në të njëjtin ambient dhe përfshin katër godina dhe ambiente të tjera shërbimi. IAL disponon ambiente dhe kapacitete të mjaftueshme për realizimin e procesit mësimor.</p>
--	---

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>IAL vë në dispozicion të studentëve të programit në fjalë bibliotekën me ambiente leximi, kompjuterë si dhe me titujt elektronike dhe jo-elektronike. Për shumicën e lëndëve të programit literatura e detyrueshme gjendet në bibliotekë; përditësimi i titujve mbetet sfidë e vazhdueshme. Biblioteka ka abonime në baza të dhënash të ndryshme që mundësojnë akses të studentëve dhe stafit në disa revista akademike prestigjioze si Maastricht Journal of European and Comparative Law, International Journal of Discrimination and the Law, Netherlands Quarterly of Human Rights. Stafit i bibliotekës vjen në ndihmë të studentëve edhe duke shkarkuar artikuj akademikë që mund të jenë të përshtatshëm për programin e studimit.</p> <p>Përgjegjësit e programit kanë pasuruar vit pas viti bibliotekën me tituj të rinj. GVJ u informua për botimet e reja sipas fushave të studimit: praktikë kjo që nis me Departamentin dhe më pas me miratimin e blerjes/shpenzimeve nga titullarët e Fakultetit.</p> <p>Gjithashtu, ambientet e Bibliotekës ishin të përshtatshme për studentët e këtij programi (por edhe për të gjithë studentët e tjerë të IAL) që të mund të lexojnë dhe përgatiten për seminarët apo provimet. Biblioteka ka orare shërbimi në dispozicion të studentëve dhe personelit të përshtatshme me programet e</p>
--	---

studimit dhe nevojat e studentëve: e hënë - e premte 9.00-20.00, e shtunë 9.00 - 17.00.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Infrastruktura në përgjithësi lejon për një mbarëvajtje normale të aktivitetit mësimor dhe kërkimor.

Auditorët janë të përshtatshëm për procesin mësimor - disa salla janë më komode se të tjerat, në veçanti auditori në katin e parë ku zhvillohen edhe aktivitetet e UET në funksion të mediatizimit dhe rritjes së vizibilitetit të tij, përshirë këtu edhe programin e studimit Master Profesional në Drejtësi me profile. Sallat me pamje nga lumi Lana (rruga kryesore) kanë më shumë zhurma që mund të çenojnë cilësinë e mësimdhënies, ndaj sugjerohet që në të ardhmen të konsiderohet mundësia e një izolimi për çështje akustike.

Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie, në përputhje me qëllimet e programit.

Nga vizita në IAL u informuam se studentët marrin pjesë në gjyqe imituese - në këtë këndvështrim do të sugjerohet që një nga sallat e seminareve të mund të ri-dizenjohet në formën e një salle gjyqi për një konkretizim të plotë të zhvillimit të një gjyqi imitues, aq më tepër kur masteri profesional synon përgatitjen praktike të tyre për të ardhmen.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. IAL ofron infrastrukturë të qëndrueshme dhe të përshtatshme për veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe administrative për programin e studimit Master Profesional në "Drejtësi", me profile në të Drejtën Administrative, Evropiane dhe Ndërkombëtare, salla për zhvillimin e procesit të mësimdhënies, bibliotekën, ambiente të tjera ku zhvillohen aktivitete shkencore, profesionale dhe network-u për studentët, që i shërbejnë studentëve nga njëra anë dhe pedagogëve nga ana tjetër, për rrjedhojë **standardi II.5 plotësohet me sugjerimin që nëse përdoren sallat me pamje nga rruga ato të izolojnë në vijim.**
2. IAL vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e universitetit e cila ofron databazë elektronike dhe një shumëllojshmëri titujsh leximi si dhe lehtësi studimi në sallën e leximit. Literatura e detyrueshme përgjithësisht ofrohet në bibliotekën e IAL për të gjitha lëndët e programit. Studentëve u vihet në dispozicion edhe literaturë shtesë të cilën mund

ta aksesojnë vetë nëpërmjet e-library ose edhe nëpërmjet katalogut elektronik. Sugjerojmë të ecet në këtë rrugë dhe të merren masa të mëtejshme për përmirësimin e shërbimeve të bibliotekës dhe për informimin e vazhdueshëm të studentëve lidhur me literaturën shtesë të ofruar. Si rrjedhojë, GJV konkludon se **standardi V. 1 plotësohet**.

3. IAL vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore, por IAL-së i mungojnë salla laboratorike tipike për programet e studimit të drejtësisë, si ato të gjyqeve imituese sidomos me rëndësi për këtë program studimi, për rrjedhojë **standardi V.2 plotësohet pjesërisht**.

GVJ konkludon se standardet e lidhura me rubrikën 4 “Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit” plotësohen kryesisht.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkimore

Burimi kryesor i financimi në IAL, dhe për pasojë edhe për programin e studimit që kërkohet të akreditohet, janë tarifatat e shkollimit që vijnë nga pagesa e studentëve në të gjitha ciklet e studimeve. Financime të tjera IAL krijon edhe nga aktivitetet tregtare (qiradhënie, parkim, etj., ndërkohë që gjatë viteve 2013-2016 zë në të ardhurat e IAL kanë edhe kontributet e granteve për kërkim dhe kontratat. Nga RVB (fq. 33) vihet re që mungojnë të dhënat lidhur me këto aktivitete për vitin 2017. Gjithashtu, nga RVB që analizon Financimin dhe Menaxhimin e Burimeve Financiare, vihet re që të dhënat janë në nivel IAL dhe jo në nivel programi. Kjo sasi të dhënash është e mjaftueshme për të bërë analiza dhe për të nxjerrë konkluzione, por në funksion të matjes sa më të mirë e të kostove dhe burimeve të financimit për një program studimi (gjë që lehtëson më pas edhe në marrjen e vendimeve nga autoritetet drejtuese të IAL) *do të sugjeronim që krahas të dhënave makro në nivel IAL, të reflektohen edhe të dhënat (të ardhurat dhe shpenzimet) edhe për programin Master Profesional në Drejtësi me profile.*

Raporti nuk reflekton të dhëna lidhur me shpenzimet e kryera nga IAL, por vetëm të dhëna për të ardhurat, si në rang IAL ashtu edhe në rang programi, ndaj *do të sugjeronim që në të ardhmen këto të dhëna të ishin pjesë e RVB.*

Gjithashtu, RVB nuk reflekton rolin e Departamentit të Drejtësisë në hartimin e buxhetit dhe në shpenzimet e kryera në funksion të tij. Nga vizita në institucion u kërkuan praktika të përfshirjes së Departamentit në procesin e hartimit të buxhetit dhe rezultoi që komunikimi ka qenë i suksesshëm lidhur me blerjen e teksteve dhe materialeve në funksion të programit të studimit. Në të ardhmen do të sugjeronim që të bëhej një programim më i mirë i burimeve financiare dhe mënyrës së shpenzimit të tyre në bashkëpunim me Departamentin për një eficiencë edhe më të madhe të programeve sidomos me natyrë praktike të cilat mund të gjejnë shtrirje dhe diapazon edhe në të ardhmen duke targetuar një numër edhe më të madh studentësh.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

• Grantet për kërkim - GK

Viti akademik	Shuma e GK	Totali i të ardhurave për vitin	% e të ardhurave nga Grantet për Kërkim në varësi të të ardhurave të përgjithshme
2011	Nuk ka	612.410.363	0
2012	Nuk ka	620.444.205	0
2013	13.118.534	683.224.560	1.92
2014	3.033.080	687.160.813	0.44
2015	7.607.575	814.545.307	0.93
2016	19.984.447	860.888.586	2.32
2017	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna

• Tarifat e shkollimit për vitet e mëposhtme kanë qenë burimi kryesor i të ardhurave për IAL; ato kanë mbuluar rreth:

- viti 2011 99%,
- viti 2012 99.9%,
- viti 2013 93.8%;
- viti 2014 93.88%;
- viti 2015 83.38%;
- viti 2016 85.48%.

• Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, rezidencat, etj):

- viti 2011 0.95%,
- viti 2012 0.05%,
- viti 2013 4.2%;
- viti 2014 5.67%;
- viti 2015 15.68%;
- viti 2016 12.19%.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Nga të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues (RVB fq. 33) rezultojnë se shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student janë si vijon:

- 2014-2015	3.428 (numri studentëve)	175.980 (kosto për studentët)
- 2015-2016	4.149 (numri studentëve)	165.100 (kosto për studentët)
- 2016-2017	4.066 (numri studentëve)	182.500 (kosto për studentët)

Rezultojnë se kosto për studentët për vitin akademik 2016-2017 zë 86% të të ardhurave të universitetit, për vitin akademik 2015-2016 84% dhe për vitin akademik 2014-2015 87.7%.



Bazuar në të dhënat e RVB-së (fq. 33), IAL llogarit koston e studimit për student në të gjitha programet e institucionit, por jo në mënyrë të dedikuar për programin e studimit Master Profesional në Drejtësi, me profile në të Drejtën Administrative, Evropiane dhe Ndërkombëtare.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion, sidomos intervista me pedagogët, rezultoi se pagesa e tyre përbëhej deri në 2017 nga dy komponentë të rëndësishëm. Pjesa e parë e kësaj pagese, e cila është fikse lidhej me zhvillimin normal të aktivitetit mësimor dhe pjesa e dytë paguhej në varësi të kërkimit shkencor që realizonte dhe publikimeve që realizonte gjithsecili për këtë qëllim. Nga këto të dhëna rezulton se granti për kërkim shpërndahej tek personeli akademik, në varësi të publikimeve shkencore që ata paraqesin në strukturat përkatëse të IAL-së. Që nga viti akademik 2017-2018, rezulton se pagesa përbëhet vetëm nga komponenti i pagës për zhvillimin e aktivitetit mësimor dhe shkencor, e cila këtë përfshirë edhe grantin për kërkimin.

Gjithashtu, nga IAL u kërkuan të dhëna specifike për të ardhurat dhe shpenzimet për programin për të cilin kërkohet akreditim. Ky informacion u vu në dispozicion nga IAL për të ardhurat nga tarifat e studentëve në vitet 2016-2017 dhe 2017-2018.

Nga tabelat rezulton që të ardhurat kryesore të programit janë nga tarifat e studentëve dhe që kosto e studimit në përgjithësi përafrohet me tarifat e studentëve, duke konfirmuar faktin që pagesat e tyre kanë shkuar në funksion të mësimdhënies. (shih tabelat 6/1 dhe 6/2)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të</p>	<p>Institucioni harton projektin financiar në muajin korrik të çdo viti; ai miratohet nga aksionari i vetëm i kësaj shoqërie tregtare (sh.p.k). Projekti hartohet në mënyrë që të ketë një rezervë të të ardhurave, me qëllim që të mbulohen shpenzimet në vazhdimësi për çdo student deri në diplomimin e tij. Për pasqyrat financiare të çdo viti Audituesi i pavarur ose ai ligjor jep opinionin lidhur me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin aspektet financiare si dhe pozicionin financiar të shoqërisë (Sh.p.k) deri në 31 Dhjetor të çdo viti, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Raporti vjetor i auditimit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe të ardhurat e tjera në funksion të rritjes së kapaciteteve mësimdhënëse dhe kërkimit</p>

<p>rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>shkencor si dhe të cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p> <p>Zv. Administratori dhe Zyra e Financës janë të ngarkuar me zbatimin e buxhetit të institucionit.</p>
<p>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni realizon auditime financiare çdo vit akademik; nga auditimi dalin të dhënat në lidhje me kostot për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe për të lehtësuar vendimmarrjen për cilësinë dhe efektshmërinë e programeve të studimit.</p> <p>Institucioni ka qëndrueshmëri financiare, e cila vjen kryesisht nga tarifat e studentëve dhe nga aktivitetet e shërbimit shtesë që IAL zhvillon, duke përfshirë të ardhurat nga aktivitetet tregtare dhe Grantet e Kërkimit dhe projektet.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. IAL bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare, për rrjedhojë standardi II.9 plotësohet. 2. IAL harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve, për rrjedhojë standardi VI.1 plotësohet. <p>Duke qenë se IAL ofron qëndrueshmëri financiare dhe aplikon auditim periodik si dhe raport financiar të programeve, GVJ konkludon se standardet e lidhura me rubrikën 5 “Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare” plotësohen plotësisht.</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkriimore

Në bazë të RVB (fq. 35, para. 1), Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë / NJSBC e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve *ad hoc*, dhe që nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit (RVB, fq. 35). Njësia e NJSBC-së është e rregulluar në Statutin e UET, miratuar me Urdhër 90, datë 28.2.2017, dhe Rregulloren e Brendshme të UET-së. Neni 11 i Statutit parashikon se [11.1] *Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet: [11.2]*

Strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet të UET. [11.3] Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë / NJSBC vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore të Universitetit dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësitë e UET, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen'. Neni 7 i Rregullores së IAL parashikon se 'Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë / KSBC është njësi autonome operative e përhershme në strukturën organizative të Universitetit. Komisioni përbëhet nga Kryetari si dhe nga anëtarë që përfaqësojnë çdo fakultet, personelin ndihmës - akademik ose administrativ, si dhe një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve'. NJSBC-ja përbëhet nga përfaqësues të 3 fakulteteve të UET-së që janë ekspertë të fushës: gjithsej janë 11 anëtarë, pedagogë të IAL, studentë dhe anëtarë të jashtëm. (shih Tabela nr. 6: Të dhëna për anëtarët e NJSBC).

Mbështetur në RVB (fq. 35-36), si dhe në takimin me kryetarin dhe një përfaqësues të NJSBC rezultojnë se kjo e fundit përmbush funksionet e saj nëpërmjet këtyre aktiviteteve kryesore:

- vlerësimin e provimeve, monitorimin/vlerësimin e syllabus-eve,
- pyetësorët me studentët
- marrja e mendimit nga 'fokus grupet' me studentët për çdo semestër (GVJ-ja u njoh edhe me materialin 'Pyetjet për Fokus-grupin 2017-2018'), si dhe
- konsultimi me Bordet e Tregut të Punës të ngritura për çdo departament.

NJSBC funksionon mbi bazën e një Plani Veprimi ku parashikohen aktivitetet kryesore, por ka dhe aktivitete rast pas rasti. Plani i Veprimit përcakton ciklin e programit që i nënshtrohet këtij kontrolli dhe periudhën kohore gjatë vitit akademik. Të gjitha aktivitetet e përmendura përfshihen në këtë Plan Veprimi. GVJ-së iu vu në dispozicion Plani i Veprimit për vitin akademik 2016-2017 për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Ky plan veprim përcakton aktivitete kryesore si: mësimdhënia, kërkimi shkencor, sigurimi i cilësisë, dhe administrimi i aktivitetit akademik. Konkretisht disa nga veprimtarisë e Planit të Veprimit janë: hartimi i syllabuseve sipas formatit standard, monitorimi i provimeve, monitorimi i pyetësorëve të studentëve dhe fokus grupeve; Realizimi i veprimtarive individuale të punës kërkimore – shkencore; Trajnime për sigurimin e cilësisë në nivel institucional; Planifikimi i mbledhjeve të organeve drejtuese të IAL-së; Vlerësimi i performancës së stafit të brendshëm akademik, etj.

NJSBC ka marrë pjesë në trajnime ofruar përmes projekteve ndërkombëtare nga ASCAL për të rritur kompetencën e vet.

Praktika e angazhimit të ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit të brendshëm është pozitive pasi i mundëson institucionit të kompletojë spektrin e vlerësimit të programeve të studimit dhe të cilësisë, dhe mundëson një vlerësim të pavarur, objektiv dhe kritik, krahas vlerësimit nga ASCAL. Do të sugjerohet që kjo praktikë të ndiqet edhe në vijimësi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit

Nga RVB nuk arrijmë të marrim të dhëna sasiore mbi për shembull anketimet që janë bërë me studentët për programin e studimit në fjalë, edhe pse theksohet (fq. 35) se ato realizohen dy herë në vit. Gjatë shqyrtimit në zyrën e burimeve njerëzore të dosjeve të një numri të caktuar

pedagogësh ndër vite, u konstatua se për pedagogët ekzistojnë vlerësimet që janë bërë nga studentët si dhe vlerësime nga kolegë të tyre brenda departamentit dhe nga përgjegjësi i departamentit. Po ashtu, nga takimi me NJSBC u informuam se për hartimin e kurrikulave dhe për çështje të tjera të mësimdhënies, vlerësimi i pedagogëve bëhet nga një komision ndërdisiplinor, që do të thotë një vlerësim lidhur me cilësinë edhe nga pedagogë të disiplinave të tjera. Gjithsesi, të dhëna sasiore nuk mund të deduktohen qartë nga dokumentacioni.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë realizohet nga NJSBC, e cila është një strukturë që funksionon që nga fillimi i vitit 2012 e në vijim. NJSBC ka hartuar Planin e Veprimit për vitin 2016-2017, pjesë e të cilit është monitorimi i veprimtarisë akademike dhe asaj administrative. Metodologjia e ndjekur në këtë drejtim është vizita në zyrë/njësi dhe analizimi i dokumentacionit mbi të cilin operon njësia.

Vend të rëndësishëm gjatë këtij plani të kontrollit të brendshëm të cilësisë, është kontrolli i kurrikulave dhe i literaturës nga NJSBC, që shoqërohet edhe me vlerësimin e performancës së mësimdhënies së një pedagogu. NJSBC ka vlerësuar edhe opinionin e studentë dhe të stafit ndaj njëri-tjetrit, dhe RVB (fq. 36) deklaroi se për çdo vlerësim plotësohen raportet përkatëse, dhe rezultatet e dala vlerësohen nga Departamenti dhe Dekanati i Fakultetit të Drejtësisë. Nga takimi me pedagogë të programit, u informuam se vlerësimet ndaj tyre janë periodike si nga ana e NJSBC ashtu edhe nga studentët dhe kolegët. GVJ-ja gjithashtu mori informacion të njëjtë nga takimi me studentët. GVJ-ja u informua se ka pasur raste që këto vlerësime kanë ndikuar në marrjen e masave graduale që pedagogu të mund të reflektonte në cilësinë e syllabusit, cilësinë dhe teknikat e mësimdhënies, literaturës, etj.

Nga takimi me studentët e programit, u informuam se këto vlerësime zhvillohen periodikisht, edhe pse studentët informuan GVJ-në se pa pritje afatin e vlerësimit kanë komunikuar me pedagogun në mënyrë individuale duke i kërkuar për shembull më shumë literaturë, gjuhë më të thjeshtë komunikimi dhe interpretimi, etj. Studentët informuan GVJ-në se pedagogët kanë qenë të hapur për të pranuar kritikën e studentëve dhe për të reflektuar rreth tyre. Ata theksuan fort si një aspekt mjaft pozitiv komunikimin e vazhdueshëm dhe të pa lodhur të pedagogëve me studentët si gjatë orarit të mësimin, ashtu edhe pas tij, si gjatë kohës së kushtuar për pritjet e studentëve ashtu edhe jashtë kësaj kohe.

RVJ, ndonëse kryhen vlerësime periodike me disa komponentë, nuk ka të dhëna sasiore lidhur me numrin e monitorimeve apo takimeve që pedagogët zhvillojnë me studentët në funksion të rritjes së cilësisë, apo të proceseve të tjera vlerësuese të tyre nga kolegët apo të vlerësimit të kurrikulave, ndaj *do të sugjerohet që në të ardhmen këto të dhëna të jenë të plota dhe që pedagogët dhe studentët të informohen edhe nëpërmjet faqes së internetit të UET si procese të zakonshme, periodike dhe të natyrshme të vlerësimit të cilësisë në procesin e mësimdhënies.*

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- ✓ Plan Veprimi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UET, Viti Akademik 2016-2017
- ✓ Formulari i vlerësimit të studentit për pedagogun dhe lëndën 'Studime të Avancuara në të Drejtën Publike'
- ✓ Formulari i vlerësimit pedagogut nga pedagogu për lëndën 'E drejta publike'

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<p>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); b. Dëgjime në auditor; c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë 	<p>IAL përdor metodologji vlerësimi për ecurinë e programit të studimit në fjalë të drejtpërdrejta si p.sh. dëgjime në auditor, rezultatet e studentëve në formate të ndryshëm vlerësimi, si dhe të tërthorta si p.sh. pyetësorë, fokus-grupe, etj. Vlerësimi fillon me hartimin e syllabuseve të lëndëve që kryhet nga komisione ndër-disiplinore në Departament.</p> <p>IAL organizon vlerësime periodike të pedagogëve nga studentët, vlerësime të pedagogëve nga kolegët e tyre brenda Departamentit, nga Përgjegjësi i Departamentit ose edhe nga pedagogë të tjerë të angazhuar brenda IAL në disiplina të tjera.</p> <p>Komponent tjetër integral për vlerësimin e cilësisë është edhe marrja e mendimit nga 'fokus grupet' me studentët për çdo semestër (siç rezultojnë nga RVB dhe vizita e GVJ-së në IAL, si dhe nga këqyrja e një modeli pyetjesh të përdorura për fokus-grupin gjatë vitit akademik 2017-2018) si dhe vlerësimi i provimeve.</p>

<p>zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	
---	--

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>IAL synon të sigurojë cilësinë e programit të studimit nëpërmjet një strukture të qëndrueshme si NJSBC e cila vepron në bazë të një plani veprimi. NJSBC publikon relacione mbi monitorimet e kryera.</p> <p>Institucioni nuk ka të publikuar në faqen e internetit rezultatet e monitorimeve apo vlerësimeve nga NJSBC, ndonëse monitorimet, vlerësimet e kurrikulave apo vlerësimi i proceseve të ndryshme kryhen periodikisht - Raporti i fundit i vlerësimit të brendshëm që pasqyron indikatorë vlerësimi për Programin e studimit Master Profesional në Drejtësi me profile është ai i prill 2018. Gjithsesi, indikatorët e vlerësimit edhe aty nuk pasqyrohen me të gjitha të dhënat e përpunuara.</p>
---	--

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>IAL ka paraqitur programin e Masterit Profesional në Drejtësi me Profile, i cili përmban të dhëna sasiore dhe cilësore mbi programin e studimit; në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe kërkesave të studentëve programi është rishikuar duke përfshirë lëndë më praktike dhe më të fokusuar tek specializimi i studentëve.</p> <p>Lidhur me hartimin e politikave, IAL ka parashikuar në misionin e saj rritjen e vazhdueshme të cilësisë së programeve të</p>
--	---

	<p>studimit që ofron, përfshirë këtu edhe programin e Masterit Profesional në Drejtësi me Profile. Përmirësimi vjen nga vlerësimi i vazhdueshëm i kurrikulave në drejtim të përditësimit të tyre dhe pasurimit me literaturë shtesë, nga matja e performancës së pedagogëve (përfshirë këtu edhe performancën e dhe stafit administrativ në funksion të programit të studimit).</p> <p>Këto politika janë të përgjithshme dhe më pas zbresin në nivel njësie departamenti nëpërmjet diskutimeve dhe reflektimeve.</p>
--	---

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>IAL është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programit të studimit në fjalë. IAL ka krijuar NJSBC si njësi të përhershme e ngarkuar me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo njësi vepron mbi bazën e një plani veprimi. Dokumentacioni i paraqitur dëshmon për praktikën e NJSBC si njësi monitoruese. Konkluzionet e këtyre monitorimeve përgjithësisht diskutohen kryesisht në Departament dhe më pas kur reflektohen problematika edhe në Dekanat, Rektorat, Senat.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

1. IAL përdor metodologji (të drejtpërdrejta dhe të tërthorta) për vlerësimin e ecurisë së programit të studimit në fjalë, për pasojë **standardi I.10 është plotësuar.**
2. IAL ka tashmë një praktikë të konsoliduar duke krijuar njësinë për sigurimin e brendshëm të cilësisë, NJSBC e cila ndërmer monitorime dhe vlerësime periodike për programet e mësimdhënies, si dhe monitoron krahas veprimtarisë akademike edhe veprimtarinë administrative në funksion të saj. IAL harton politika të përgjithshme të kontrollit dhe vlerësimit të cilësisë të programeve të ciklit të dytë, të cilat zbresin më pas në nivel departamenti nëpërmjet diskutimeve dhe reflektimeve, megjithatë do të

sugjerohet që këto vlerësime të jenë të dedikuara ndaj programit, natyrisht në koherencë edhe me vlerësimin e përgjithshëm të programeve të tjera.

IAL duhet të garantojë që politikat e monitorimit dhe vlerësimit nga NJSBC të publikohen edhe në faqen e internetit të IAL, së bashku me metodologjinë e hartuar për këtë qëllim. IAL nëpërmjet Departamentit dhe njësive të tjera të programit të studimit, duhet të zbatojë një mekanizëm konkret për vlerësimin e programit të studimit. Konkluzionet e dala nga monitorimi duhet të paraqiten në Raporte vjetore (ose edhe semestrale), së bashku me hapat konkretë (road map) për ndryshimet e nevojshme. Në këtë kontekst, **standardet I.13, II.7 dhe VIII.1 plotësohen kryesisht, me sugjerimet e përmirësimeve të pjesshme.**

GVJ konkludon se standardet e lidhura me rubrikën 6 “Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë” plotësohen kryesisht, me sugjerimet sa më sipër.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Programi i studimit ka në misionin e tij formimin profesional të studentëve në të drejtën administrative, ndërkombëtare dhe evropiane, në varësi të profilit të zgjedhur nga studentët. Programi është i organizuar në një vit mësimor që përbëhen nga dy semestra. Programi mësimor realizohet me orët mësimore në auditor (në formën e leksioneve dhe seminareve në raportet 2/1) si dhe në orët jashtë auditorit (raporti orë në auditor me jashtë auditorit është në raportin: leksionet 28 orë në auditor dhe 34.5 orë punë e pavarur e studentit, seminarët 14 orë në auditor dhe 36 orë punë e pavarur e studentit. Literatura dhe materiale të tjera të detyrueshme, mbështetëse dhe ndihmëse janë kryesisht në shqip si dhe në anglisht. Në funksion të programit ka dhe disa botime të UET Press.

Programi aktualisht funksionon bazuar në Rregulloren e vjetër të miratuar nga Senati, e cila në bazën ligjore i referohet Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 'Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë' - ndonëse një pjesë e procedurave të funksionimit të programit nuk ka ndryshime me ligjin aktual No. 80/2015 'Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH' lidhur me rolin e IAL në administrimin e programeve të studimit, *rekomandohet përditësimi i Rregullores Mësimore të programit të Masterit Profesional në Drejtësi në reflektim të kërkesave dhe detyrimeve të tij, së bashku me Aneksin ku listohen kategoritë e profesioneve që mund të punësohet studenti pas përfundimit me sukses të programit.*

Programi formon studentët për profesionet e Juristit në administratën publike në nivel qendror/vendor si dhe në pozicione që kërkojnë kualifikim praktik, si Jurist në institucione të pavarura (p.sh. KLSH, Avokati i Popullit, Avokati i Prokurimeve, etj.), Jurist në kompani/biznese private, Jurist në OJF vendase/ të huaja dhe organizma ndërkombëtare. (Shih Aneksin e Rregullores së Programit të studimit, fq. 9).

Në këtë program studimi ofrohen lëndë/module të:

- Formimit të përgjithshëm - 1 lëndë me 6 kredite
- Formimit karakterizues - 3 lëndë me 6 kredite secila (18 kredite)
- Disiplina integruese - 2 lëndë me nga 6 kredite secila (12 kredite)

Lëndët e formimit të përgjithshëm dhe formimit karakterizues ofrohen për të tre profilet - në të Drejtën Administrative, Ndërkombëtare dhe Evropiane, ndërsa 2 lëndë të tjera të disiplinave integruese janë specifike për secilin nga profilet (RVB fq. 41).

Nga programi i studimit, vihet re se të gjitha lëndët janë të detyrueshme dhe nuk ka hapësira që studenti të ketë mundësi të zgjedhë lëndë të tjera shtesë sipas interesit të formimit profesional - në takimin që u zhvillua me pedagogët e Departamentit, u informuam se kjo strukturë në vetvete reflekton një profilizim, duke inkorporuar edhe qasjen ndaj lëndëve me zgjedhjeve pasi disiplinat e integruara konsiderohen të tilla.

Gjithashtu, në asnjë prej programeve të lëndëve nuk vihen re tema apo module që lidhen me aftësimin praktik të studentëve si psh. hartimi i një shkrese me natyrë administrative, i një opinionit ligjor, i një Memorandumi, i përmbledhjeve të çështjeve etj, që janë pjesë e shkrimit ligjor, në një nivel më të avancuar siç është programi i Masterit Profesional në Drejtësi.

*Në këtë kontekst, do të sugjeronim që në të ardhmen të shikohet mundësia e përfshirjes së disa **lëndëve me zgjedhjeve** në mënyrë që të reflektohet edhe më qartë profilizimi i studentëve dhe përgatitja e tyre për tregun e punës. Kjo gjë mund të realizohet në bashkëbisedim me studentët për të vjelë mendimet e tyre se cilat do të ishin mundësitë apo opsionet më të përshtatshme për ta, duke konsultuar modele të ngjashme të universiteteve të huaja, apo edhe duke konsideruar zhvillimet e fundit ligjore dhe social-ekonomike-politike, natyrisht të transpozuar në kontekstin ligjor e që lidhen me programin e studimit (p.sh. reforma në drejtësi në komponentët e saj, integrimi në BE dhe gjetjet nga Progres Raporti i BE që ndryshojnë në disa elementë çdo vit, apo edhe jurisprudenca e GJEDNJ e cila është në ndryshim dhe pasurim të vazhdueshëm, sidomos me çështjet kundër Shqipërisë) në mënyrë që të jetë atraktiv edhe për studentët në të ardhmen dhe të jetë më i vlefshëm në cilësinë dhe aktualitetin e njohurive që ofron.*

*Gjithashtu, do të sugjeronim që në modulet e lëndëve të ketë tema të dedikuara **përgatitjes praktike** së studentëve ose futjes krahas modulit Metodat e Kërkimit Shkencor edhe moduli i dytë i tij 'Shkrimi Ligjor' duke u emërtuar MKSH & SHL.*

***Një opsion tjetër që mund të jetë më i përshtatshëm për formimin praktik të studentëve të programit Master Profesional në Drejtësi me profile është që lënda Metodat e Kërkimit Shkencor të ri-organizohet duke u titulluar '**Kërkimi dhe Shkrimi Ligjor**' pasi reflekton që në titull, e natyrisht më pas edhe në përmbajtje qasjen praktike të studentëve për hartimin e dokumenteve ligjorë, duke i aftësuar ata për tregun e punës.*

Programi i studimit paraqet se nga lëndët e detyrueshme që janë të përbashkëta për të tre profilet (RVB fq. 41), konkretisht:

- Metoda kërkimi në shkenca juridike (MKSH)
- Studime të avancuara në të drejtën publike (SAvDP)
- Studime të avancuara në të drejtën administrative (ASvDA)
- Të drejtat e njeriut (Debati bashkëkohor dhe Jurisprudenca) (DNj)

vetëm tre zhvillohen semestrin e parë (MKSH, SAvDP, dhe DNj) - do të sugjeronim një rishikim të programit në mënyrën e organizimit të tij, duke qenë se te gjitha lëndët kanë të

njëjtën sasi kreditesh 6 ETC, që lëndët e përbashkëta të tre profileve të zhvillohen semestrin e parë pasi janë lëndë formuese, dhe lëndët e profileve të zhvillohen semestrin e dytë së bashku me Praktikën Mësimore (*Shih tabelën nr. 24*) - në këtë mënyrë semestrin e parë studenti do të plotësojë 24 ECTC (4 lëndë x 6 ECTC /Lëndë) dhe semestrin e dytë 24 ECTC, nga të cilat 12 ECTC nga 2 lëndët e profilit dhe 10 ECTC nga Praktika Mësimore. Ndërkohë që diploma llogaritet me 14 ECTC dhe mund të klasifikohet si një punim në funksion edhe të praktikës mësimore në semestrin e dytë.

Lidhur me Praktikën Mësimore, nga takimi që zhvilluam me studentët, rezultoi se vlerësonin faktin që programi ofron mundësinë për të marrë njohuri praktike për profilin që kishin zgjedhur, por shprehën sugjerimin se vetë IAL duhet të koordinohet me institucionet ku ata të kenë mundësi të zhvillojnë praktikën duke e përcaktuar institucionin paraprakisht dhe duke informuar studentët që në fillim të semestrit të dytë - *në këtë kontekst sugjerojmë që procesi i Praktikës Mësimore të institucionalizohet në marrëveshje paraprake të IAL me institucionet sipas profileve.*

Në këtë program studimi ndiqen dhe procedurat e transferimit të studimeve nga IAL brenda apo jashtë vendit (*ekuivalentimi i krediteve të fituara*); kryesisht u konstatua që studentët transferonin ose synonin të transferonin studimet nga programi i Masterit Profesional në Drejtësi tek programet Master Shkencor që ofrohen brenda së njëjtit institucion.

Për vitin akademik 2011-2012, 2012-2013 dhe 2013-2014 nuk ka pasur studentë të transferuar; për vitin 2014-2015 ka pasur një student të transferuar në vitin e parë dhe një në vitin e dytë pra 2 (dy) studentë gjithsej;

për vitin 2015-2016 ka pasur dhjetë studentë të transferuar në vitin e parë dhe një në vitin e dytë pra 11 (njëmbëdhjetë) studentë gjithsej;

për vitin 2016-2017 ka pasur vetëm një student të transferuar në vitin e parë, dhe

për vitin 2017-2018 nuk ka pasur asnjë student të transferuar.

Totali i studentëve të transferuar për vitet 2011-2018 është 14 (katërmëdhjetë) studentë
(Tabela 15 - Anekset e RVJ)

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e programit të studimi

Programi i studimit Master Profesional në Drejtësi me profile në të Drejtë Administrative, Ndërkombëtare dhe Evropiane, fillimisht ka qenë i organizuar në 90 ETC që shtriheshin në një kohëzgjatje 1 vit e gjysmë, por që nga viti akademik 2016-2017 organizohet në 60 ETC dhe me kohëzgjatje një vit akademik (*shih përkatësisht Tabelat 7 dhe 9 tek Anekset e RVJ*).

Programi synon të pajisë studentin me:

- Thellim, zgjerim dhe specializim të koncepteve;
- Formim tematik dhe jo panoramik apo historik;
- Aftësi për kërkim të avancuar e të pavarur praktik;
- Përvetësim të literaturës kryesore të fushës së studimit;
- Angazhimin në praktika profesionale

- Hartim i temës së Diplomës me origjinalitet, me karakter empirik dhe praktik, produkt krijues i studentit për analiza dhe zgjidhje praktike.

Praktika Profesionale (E) që ka 10 kredite - 10 ECTS, dhe Teza e Diplomës (F) që ka 14 kredite - 14 ECTS janë pjesë e kurrikulës dhe zhvillohen në përfundim të procesit mësimor.

Programi i ofron studentëve në përfundim të tij diplomën e emërtuar Master Profesional në të Drejtë Publike në profilin a) E Drejtë Administrative; b) E Drejte Evropiane dhe c) E Drejtë Ndërkombëtare (sipas profilit të zgjedhur).

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në “Drejtësi”, me profile, ofrohet me tre profile: a) E drejtë administrative; b) E drejte evropiane c) E drejtë ndërkombëtare, është i ndërtuar si vijon:

- është i shtrirë në 1 vit akademik;
- 1 (një) vit akademik ka 28 javë në auditor dhe 2 (dy) semestra;
- 1 (një) semestër ka 14 javë në auditor;
- 1 (një) ECTS ka 25 orë mësimore pune të studentit;
- 1 orë mësimore - 60 min, pasqyruar kjo edhe nga RVB (fq. 40)
- Orët mësimore në auditor plotësohen në orë jashtë auditorit - 14 orë punë e pavarur e studentit për leksionet dhe 18 orë punë e pavarur e studentit për seminarët (RVB fq. 41).
- Praktika Profesionale ka 10 kredite - 10 ECTS, dhe
- Teza e Diplomës (F) ka 14 kredite -14 ECTS.

Plani mësimor, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Në planin mësimor fillestar, të organizuar me 90 ECTS (tabela nr. 10, RVB) paraqitet ndarja e krediteve (ECTS) sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (RVB faqe 40-43). Të gjitha lëndët kanë një numër të njëjtë kreditesh, 6 të tilla, pavarësisht rëndësisë që mund të kenë lëndë të ndryshme në formimin e studentëve, me përjashtim të Praktikës mësimore dhe Tezës së Diplomës që kanë përkatësisht 10 dhe 14 kredite.

Më pas, me ndryshimet e organizimit të Programit Master Profesional në Drejtësi me Profile nga 90 në 60 ECTS, edhe raporti leksioneve/seminareve ka ndryshuar, si më poshtë (Shih Tabelen 13, tek Aneksët e RVJ):

Master Profesional në “Drejtësi”, me profile: A. E drejtë administrative, B. E drejtë ndërkombëtare, C. E drejtë evropiane		
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor	Orët si Punë e Pavarur
a Leksione	168	207

b	Seminare	84	216
c	Ushtrime	108	117
d	Laboratore	n/a	n/a
e	Praktikë lëndore	n/a	n/a
f	Praktikë profesionale	220	30
g	Punim diplome	20	330
	Në total	600	900

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit: (shih Tabela nr. 11 tek Aneksat e RVJ)

Kreditet përcaktohen duke llogaritur në to:

- Leksione: 11 orë në auditor dhe 14 orë pune të pavarur
- Seminare: 7 orë në auditor dhe 18 orë pune të pavarur
- Detyra kursi/Ushtrime: 12 orë në auditor dhe 13 orë pune të pavarur
- Praktikë/Internship : 22 orë në auditor dhe 3 orë pune të pavarur
- Punim diplome: 1.5 orë në auditor dhe 23.5 orë pune të pavarur të studentëve

Në Programin e Masterit Profesional përfshihen veprimtaritë mësimore si vijon:

- Veprimtari në disiplina të **formimit të përgjithshëm (A)**: përfshihet 1 lëndë me 6 kredite, në total 6 kredite;
- Veprimtari në disiplina të **formimit karakterizues (B)**: përfshihen 3 lëndë me nga 6 kredite secila, në total 18 kredite;
- Veprimtari në **disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (C)**: Për profilin: E drejtë Administrative përfshihen 2 lëndë me nga 6 kredite secila, në total 12 kredite; Për profilin: E Drejtë Evropiane përfshihen 2 lëndë me nga 6 kredite secila, në total 12 kredite; Për profilin: E Drejtë Ndërkombëtare përfshihen 2 lëndë me nga 6 kredite secila, në total 12 kredite;
- Nuk ka veprimtari ose lëndë me zgjedhje pjesë e kurrikulës
- Praktika/Internship (E) - 10 kredite
- Teza e Diplomës (F) - 14 kredite.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licencuara

Programi mësimor, ka pësuar ndryshime në funksion të përmirësimit të kurrikulës dhe të njohurive praktike e të specializuara që lëndët ofrojnë, sipas profileve; në total, lëndët që kanë pësuar ndryshim janë 3 (tre). Këto ndryshime janë si më poshtë:

- 10 % e programit për të tre profilet, pasi ka ndryshuar një lëndë me 6 ECTS e formimit karakterizues **(B)**;
- 10 % e programit vetëm në profilin e Drejtë Administrative (ndryshuar një lëndë me 6 ECTS e disiplinave të ngjashme - C) dhe

- 10 % e programit vetëm të profilit e Drejtë Evropiane (ndryshuar një lëndë me 6 ECTS e disiplinave të ngjashme - C).


Ndryshimet e Programeve	Kategoria e Lëndëve	Profilët	Nr. krediteve/ECTS	% e ndryshuar
Lënda 'E drejtë Kushtetuese e Avancuar' zëvendësohet me lëndën 'Studime të avancuara në të drejtë Publike'	B Disiplina të formimit Karakterizues	Të tre profilet	6 ECTS	10 %
Lënda 'Procedura Administrative' zëvendësohet me lëndën 'Kontrolli i ligjshmërisë së Aktit Administrativ'	C Disiplina të ngjashme dhe Integruese	Profili e Drejtë Administrative	6 ECTS	10 %
Lënda 'Europianizimi dhe përshtatja e të drejtave kombëtare' zëvendësohet me lëndën 'Studime të avancuara në të drejtë Evropiane'	C Disiplina të ngjashme dhe Integruese	Profili e Drejtë Evropiane	6 ECTS	10 %

Të dhënat u reflektuan të ishin në përputhje me të dhënat e RVB, fq. 42 - për më shumë shih Tabelën 8 tek Anekset e RVJ.

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës** (Shih Tabelat 10 - 1/2/3/4/5/6 tek Anekset e RVJ)

GVJ shqyrtoi tabelat e ndërlidhjes së planit mësimor të Master Profesional në Drejtësi me Profile, me personelin akademik përkatës, për vitet akademike 2011-2012, 2012-2013, 2013-2014, 2015-2016, 2016-2017, dhe 2017-2018, dhe rezultojnë që ka një tendencë për të angazhuar të gjithë personelin akademik efektiv në procesin e mësimdhënies për programin në fjalë. Kjo është një mënyrë efektive për të kontrolluar procesin e mësimdhënies, por duke qenë se programi është i dedikuar studimeve profesionale në drejtësi, me një qasje praktike, *do të sugjerohet që të kishte të angazhuar edhe ekspertë të fushave përkatëse, si personel akademik me kontratë, ose edhe si guest lectures pra pedagogë vizitorë për tema të caktuara.*

Viti Akademik	Nr. PAE të angazhuar në procesin e mësimdhënies	Nr. PAK të angazhuar në procesin e mësimdhënies
2011-2012	5	3
2012-2013	10	4
2013-2014	8	2
2014-2015	9	3
2015-2016	10	2
2016-2017	10	0
2017-2018	9	1



Personeli akademik është i specializuar në fushën e angazhimit në lëndët e programit. GVJ shqyrtoi CV dhe dokumentacionin përkatës të tre pedagogëve në zyrën e burimeve njerëzore (dy nga të cilët PAE dhe një PAK) për të vlerësuar specializimin e tyre në fushën përkatëse, dhe rezultoi që kishin formimin e plotë nga ana akademike për disiplinat ku janë angazhuar, por ndërkohë për vetë specifikat e programit *do të sugjeronim në të ardhmen mundësinë e angazhimit të specialistëve apo ekspertëve të fushave përkatëse për të pasuruar aspektin teorik me atë praktik për tema të caktuara.*

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë, bazuar në syllauset e vëna në dispozicion nga institucioni e të aksesuara në sistemin e-ascal, është si vijon:

Dokumentacioni në lidhje me këto programet e lëndëve u vu në dispozicion të GVJ i plotë, dhe rezultoi që nga ana formale është i plotë në të gjithë komponentët e tij teorikë. Në disa raste në programet e lëndëve ishin përfshirë edhe elementë praktikë në trajtën e kazuseve që do të analizohen nga studentët nën drejtimin e pedagogut p.sh. në lëndën e te Drejtave të Njeriut, një element tejet i rëndësishëm ky për qasjen praktike të formimit të studentëve. *Do të sugjeronim që të ardhmen të shikohet mundësia e përfshirjes së këtyre elementëve praktikë edhe në lëndët/modulet e tjera, pasi plotëson dimensionin praktik të programit të studimit.*

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabusi i çdo lënde përmban: titullin e lëndës; titullarin/grupin e pedagogëve; numrin e krediteve; kohën e realizimit të modulit; llojin e lëndës (lëndë formimi bazë apo formimi karakterizues); përshkrimin e lëndës; aftësimin e studentëve përgjatë zhvillimit të lëndës; temat që do të zhvillohen dhe numrin përkatës të orëve; temat për orët praktike dhe numrin e orëve; metodologjinë e mësimdhënies; detyrimet e studentit; formën e vlerësimit dhe komponentët përbërës të vlerësimit; literaturën e detyrueshme dhe plotësuese. Tipologjia e lëndës përcaktohet në të gjitha syllauset tek "Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës".

Çdo syllabus përcakton njohuritë që i ofron studentëve, sikurse edhe të gjitha temat javë pas javë duke specifikuar jo vetëm titullin, por edhe literaturën e kërkuar për çdo javë. Çdo syllabus përcakton ngarkesën në orë në auditor 2 leksione dhe 1 orë seminar si dhe ngarkesën në ECTS, 6 kredite.

Leksionet dhe seminarët si dhe detyrat e kurseve janë metodat e mësimdhënies së lëndëve. Në syllabuset e të gjitha lëndëve përfshihen leksionet dhe seminarët për çdo javë si forma e mësimdhënies, ndërsa detyrat zbatohen përgjatë kursit sipas përcaktimit të çdo lënde. Në syllabuse përfshihen për çdo janë edhe sqarime mbi metodën e mësimdhënies që përdoret si p.sh. diskutime rastesh, diskutime me debat, etj.

Gjatë takimit të GVJ me studentët u konfirmuan gjithashtu përdorimi i metodave të tilla mësimdhënie si lexime libri, prezantimet power-point të punëve, debate në klasë për raste konkrete, dhe në një rast edhe përfshirje në kërkim shkencor.

Për të gjitha syllabuset, forma e kontrollit të njohurive përbëhet nga: 10 % ndjekja e lëndës aktive në auditor; 20 % detyrat e kursit (si ese, komentari libri, detyrë praktike, detyrë grupi, pjesëmarrje në kërkime shkencore për studentë ekselentë, etj); 30% provimi i ndërmjetëm; dhe 40 % provimi përfundimtar. (Shih tabela 14). Mënyra e vlerësimit të studentëve bazohet në Rregulloren e programit dhe është sipas sistemit me 10 nota (4-jo kalueshëm deri 10 - nota maksimale) të konvertuara sipas sistemit me germa nga F (jo kalueshëm) deri tek A (vlerësimi maksimal). (shih Tabela 14 tek Anekset e RVJ).

Në të gjitha syllabuset, studentëve në të gjitha lëndët i kërkohet prezenca në veprimtaritë mësimore në auditor në masën 80%.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Institucioni ofron programin e studimit, akredituar me Urdhër të MAS nr. 68 Dt. 14.02.2011, program i cili është i ndarë në module dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.</p> <p>Sipas Planit Mësimor, rezultojnë se programi ka në total 6 lëndë të barabarta me 6 ECTS secili pra 36 ECTS, ndërkohë që praktika ka 10 ECTS dhe Diploma 14 ECTS. Ngarkesa mesatare e krediteve të një viti është 60 kredite.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me</p>	<p>Programi i ciklit të dytë Master Profesional në Drejtësi, me profile, ofron dije me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, duke i aftësuar studentët në drejtim të</p>

njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;

Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;

Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;

Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;

Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;

Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

kërkimit ligjor, karrierës profesionale si edhe përshtatjen në tregun e punës. Ky program studimi ndahet në profile, a) E Drejtë Administrative; b) E Drejtë Evropiane dhe, c) E Drejtë Ndërkombëtare. Diferenca midis këtyre profileve qëndron në grupin e lëndëve që ofrohen në kategorinë C (disiplina të ngjashme dhe/ose integruese), në të cilën ofrohen nga 2 lëndë të ndryshme për secilin profil, me nga 6 ECTS secila).

Ky program studimi në përgjithësi synon zgjerimin e njohurive të fituara në ciklin e parë të studimeve dhe profilizimin e aftësimin praktik të studentëve në fusha specifike. Në disa raste u evidentua se disa lëndë të cilat janë në module të njëjta me programin e Masterit Shkencor, leksionet zhvilloheshin së bashku, duke mos përmbushur plotësisht objektin e programit që është profilizimi i studentëve dhe aftësimi i tyre në çështje praktike të së drejtës psh. lënda e Metodave të Kërkimit.

Studenti që shlyen detyrimet sipas programit pajiset me diplomën përkatëse Master Profesional në Drejtësi sipas profileve.

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;

Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo

Përmbajtja dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve. Ky program studimi është i ndërtuar gjerësisht mbi bazën njohurive të fituara në ciklin e parë të studimit të fushës përkatëse dhe thëllon më tej njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me objektivat e

<p>provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>përcaktuara në ligjin 'Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH'.</p> <p>Vlerësimi i studentëve realizohet në mënyrë të vazhdueshme për gjatë semestrit ku lëndët përkatëse zhvillohen. Komponentët për gjatë semestrit përbëhen nga: ndjekja dhe aktivizimi në auditor (10%), detyrat e kursit (20%) provimi i ndërmjetëm (30%) dhe provimi përfundimtar (40 %). Kjo mënyrë e kontrollit dhe vlerësimit për gjatë semestrit jep mundësinë e plotësimit të njohurive dhe qartësime të nevojshme periodikisht.</p>
--	--

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në to metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar duke u referuar tek përvoja bashkëkohore akademike dhe është bazuar në një vlerësim të nevojave të tregut të punës në lidhje me njohuritë e thelluara në fushën e së drejtës administrative, evropiane dhe ndërkombëtare në një aspekt më të gjerë.</p> <p>Programi i studimit përmban të gjithë elementët e nevojshëm për të qenë konkurrues edhe në arenën ndërkombëtare.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin shqiptar dhe në standardet e kreditimit ECTS.</p>
---	--

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e</p>	<p>Programi i studimit përmes lëndëve të ofruara është në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve dhe i pajis studentët me dijet e nevojshme duke i aftësuar ata profesionalisht si edhe për kërkim të avancuar ligjor.</p> <p>Ky program studimi është në përputhje me profilin e UET dhe me strategjinë e tij.</p> <p>Gjithashtu rezulton se personeli akademik</p>
---	---

<p>programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>është i aktivizuar në punë kërkimore-shkencore që ka si qëllim realizimin e programeve të studimit, në funksion të arritjes së qëllimeve për të cilat funksionon ky program studimi.</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi i studimit është hartuar bazuar në disa informacione dhe konsultime që institucioni ka arritur të sigurojë në kuadër të Bordeve të Punës që ka krijuar. Vlerësimi mbi nevojat e tregut të punës është realizuar mbi bazën e një studimi të përgjithshëm të tregut ose <i>ad hoc</i> të tij.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i Studimit Master Profesional nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe ndihmon në ruajtjen e këtyre vlerave. Ky program studimi synon të përfshijë të gjithë materialin akademik dhe profesional që ofrohet në këtë fushë studimi.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>N/A</p>

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Ky program studimi realizohet në 60 ECTS me një kohëzgjatje një vit akademik. Për Praktikën/Internship janë përcaktuar 10 ECTS, ndërsa për Tezën e Diplomës përfundimtare 14 ECTS.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>N/A</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshëm për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Institucioni ka publikuar në faqen e tij të internetit informacion në lidhje me programet e studimit si edhe ka përgatitur një broshurë të plotë në lidhje me to. Modulet dhe syllabuset që janë pjesë e kurrikulës së këtij programi studimi ofrohen për studentët në formën e shkruar dhe ato janë elektronike dhe në programin LMS ku studentët kanë akses.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Informacioni i dhënë shpjegon të gjithë mënyrën e zhvillimit të programet të studimit, lëndët që duhet të jepen, si edhe mënyrën e diplomimit bashkë me afatet përkatëse.</p> <p>Për Praktikën/Internship janë përcaktuar 10 ECTS, ndërsa për Tezën e Diplomës përfundimtare 14 ECTS.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni ofron programin e studimit Master Profesional në “Drejtësi”, me profile, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, GVJ konkludon që standardi I.1 plotësohet; 2. Programi studimit është në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit, pra standardi I.2 plotësohet kryesisht, me sugjerimin që lëndë të caktuara të ofron me 	

qëllim zgjerimin e njohurive të fituara në ciklin e parë të studimeve;

3. Programi i studimit ofrohet në përshtatje me nivelin e studimeve, si rrjedhojë GJV konkludon që **standardi I.4 plotësohet;**
4. Programi i studimit synon të arrijnë dimensione ndërkombëtare, si rrjedhojë GJV konkludon që **standardi I.5 plotësohet;**
5. Programi i studimit përfshin aftësimin profesional dhe kërkimin ligjor, si rrjedhojë GJV konkludon që **standardi I.6 plotësohet;**
6. Programi i studimit Master Profesional në Drejtësi, me Profile, ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe merr parasysh në përgjithësi nevojat e tregut të punës, si rrjedhojë GJV konkludon që **standardi I.7 dhe 1.8 plotësohet, me sugjerimin që studimi i tregut të punës të kryhet mbi bazën e të cilit orientohet më tej programi duhet të jetë i dedikuar për fushat që adreson ky program;**
7. Programi i studimit Master Profesional në Drejtësi, me profile, synon ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare, si rrjedhojë GJV konkludon që **standardi I.9 plotësohet;**
8. Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programin e studimit Master Profesional në Drejtësi, me Profile, shtë në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, 'Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar, si rrjedhojë GJV konkludon që **standardi I.12 plotësohet;**
9. Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve, si rrjedhojë GJV konkludon që **standardi II.6 plotësohet;**
10. Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një **plan diplomimi**, si rrjedhojë GJV konkludon që **standardi II.8 plotësohet.**

Standardet lidhur me vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë plotësohen plotësisht, me sugjerimet sa më sipër.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Mësimdhënia në programin Master Profesional në Drejtësi me Profile, bazohet në 'Strategjinë e mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve' UET, 2011-2015. Ky dokument, përmban kuadrin institucional të zhvillimit të dijeve dhe politikat e institucionit (afatmesme dhe afatgjata) në këtë drejtim. Siç reflektohet edhe nga titulli i dokumentit, kohështrirja e saj është vetëm për periudhën 4 vjeçare, deri në vitin 2015 dhe bazohet në legjislacionin e kaluar për arsimin e lartë, ndaj do të rekomandohet përditësimi i saj në kontekstin e zhvillimeve dhe reformave të ndërmarrta në arsimin e lartë në Shqipëri, si dhe standardeve bashkëkohore ndërkombëtare, apo edhe praktikave më të mira në rajon e më gjerë. Në të njëjtin kontekst, edhe Rregullorja e studimeve të Programit është e vjetër dhe nuk reflekton ndryshimet ligjore, ndaj rekomandohet të rishikohet dhe përditësohet.

Bazuar tek të dhënat e RVB (Tabela 11, fq. 41-42), disiplinat mësimore organizohen në këto kategori:

Kategoria A: Disiplina të formimit të përgjithshëm (*Metoda kërkimi në shkenca juridike*).

Kategoria B: Disiplina të formimit karakterizues të programit ku ofrohen 3 lënde të detyrueshme për të gjithë dhe 3 lëndë që përcaktojnë diferencimin e profileve (Studime të avancuara në të Drejtën Publike, Studime të avancuara në të Drejtën Administrative dhe të Drejtat e Njeriut)

Kategoria C: Disiplina të ngjashme të programit ku ofrohen 2 lënde të detyrueshme, që përcaktojnë diferencimin e profileve.

Në profilin **e drejtë administrative:**

- Drejtësi kushtetuese;
- Kontrolli i ligjshmërisë së aktit administrativ

Në profilin **e drejtë evropiane:**

- E drejta e migracionit dhe refugjatit;
- Studime të avancuara në të drejtën evropiane

Në profilin **e drejtë ndërkombëtare:**

- E drejta diplomatike dhe protokolli diplomatik
- Gjykatat ndërkombëtare

Kategoria E: Praktika/Internship;

Kategoria F: Teza e diplomës;

RVB reflekton edhe zhvillimin e Honors Course (fq. 47), por nga takimet me IAL u informuam se këto kanë qenë praktika të mëparshme të cilat nuk zhvillohen më në programin aktual.

Në programin master në fjalë mësimdhënia zhvillohet kryesisht mbi bazën e leksioneve dhe seminareve, por nga takimi me studentët u informuam se pedagogët përdorin edhe një sërë teknikash të tjera interaktive me studentin si casuse (*hypotheticals*) dhe raste nga praktika. Gjithashtu për ta bërë sa më tërheqëse lëndën dhe për të rritur vëmendjen dhe interesin e studentëve, pedagogët aplikojnë paraqitje grafike të materialeve të tyre, prezantime me tituj dhe pika referuese, etj.

Kontrolli i dijeve të studentëve bazohet në parimin e kontrollit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të dijeve (RVB, fq. 47). Elementët përbërës të vlerësimit përfundimtar janë: pjesëmarrja aktive (10%); detyrat e kursit (20%); testimet gjatë vitit (mid-term) (30%); provimi (40%). (Për më shumë shih Tabelën 14)

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Siç u paraqit nga takimet me pedagogë dhe studentë të programit, format e mësimdhënies për këtë program studimi janë: leksione, seminare, ushtrime (punë e pavarur), praktika profesionale si dhe punimi i diplomës. Çdo lëndë trajtohet në 14 tema dhe për secilën prej tyre studentëve u

ofrohen 2 orë kontakti në auditor në formën e leksionit dhe 1 orë në formën e seminarit. Si rezultat, numri i orëve të kontaktit në auditor për çdo lëndë është 42 ore (leksione dhe seminare). Studentët angazhohen me punë të pavarur, dhe praktikë/intership (220 orë në auditor) Punimi i diplomës i angazhon ata me 20 orë në auditor. Nga biseda me një grup përfaqësues të programit të studimit rezultoi se ora e mësimit organizohet si vijon: pedagogët marrin mungesat, më pas vazhdohet me diskutimin për temën e shkuar dhe më pas vijohet me leksionin

Format e kontrollit të njohurive

Siç rezulton dhe nga RVB (fq. 46-47 dhe Tabela 15 e RBV fq. 47), si dhe nga bisedat me stafin dhe studentët në IAL, kontrolli i njohurive bazohet në parimin e kontrollit periodik dhe të vlerësimit të vazhdueshëm të dijeve. Elementët përbërës të vlerësimit përfundimtar janë: pjesëmarrja aktive (10%); detyrat e kursit (20%); testimet gjatë vitit (mid-term) (30%); provimi (40%). (Për më shumë shih Tabelën 14 të Aneksëve të RVJ dhe Tabelën 15 të RVB, fq.47). Mënyra e vlerësimit të studentëve bëhet më pikë nga 0 në 100 (shih Tabelën 12 të Aneksëve të RVJ). Pikët konvertohen në notë nga 4 në dhjetë dhe me germa nga F në A.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë

Për të dhëna mbi përfshirjen e studentëve në aktivitete shkencore në IAL, RVB nuk paraqet të dhëna. Gjatë takimit më pedagogë rezultoi se një studente është angazhuar në një studim shkencor lidhur me prokurimet publike, dhe synohet që të angazhohet edhe më tej në të ardhmen për shkak të kapaciteteve akademike që ajo ofron.

Gjatë bisedës me studentët, rezultoi se asnjëri prej tyre nuk ishte përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në kërkimin shkencor në kuadër të programit të studimit (duhet theksuar se të pranishëm në takim ishin vetëm 2 studentë), por njëri prej tyre shfaqti dëshirën për t'u angazhuar kryesisht në aktivitete profesionale, shkencore dhe aktivitete të tjera që organizohen nga IAL.

Tregues të tjerë

Tre çështje u konstatuan gjatë vizitës në IAL dhe bisedave me studentët dhe stafin:

- Së pari, studentët konstatojnë ngjashmëri dhe një diferencim të vogël midis profileve të masterit. Praktikisht profilet diferencohen nga dy lëndët me zgjedhje të kategorisë C.
- Së dyti, nga bisedat me stafin dhe studentët rezultoi se disa lëndë organizohen bashkë me masterin profesional (si p.sh. metodat kërkimore; të drejtat e njeriut; e drejtë publike; e drejta administrative). Duke patur parasysh misionet e ndryshme të masterit profesional dhe atij shkencor, duhet bërë kujdes që kjo praktikë të mos cenojë individualitetin e secilit program.
- Së treti, nga biseda me studentët rezultoi se praktika profesionale paraqet vështirësi në akses për studentët dhe në vendosje/sigurim kontaktesh nga IAL. Studentët duhet të kontaktojnë vetë një institucion pranë të cilit dëshirojnë të bëjnë praktikën, ndaj kërkuan që kjo qasje të ndryshojë duke ju lehtësuar atyre kontaktin paraprak me institucionet dhe me vijueshmërinë e procesit.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Procedura e pranimit të studentëve në programin e studimit Master Profesional është e parashikuar në "Rregullore mësimore e programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në "Drejtësi", vënë në dispozicion nga institucioni (pika 2). Sipas kësaj rregulloreje, studentët, për t'u pranuar në këtë program studimi, duhet të zotërojnë së paku një diplomë të nivelit të parë (Bachelor) ose një diplomë tjetër të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të, në të njëjtën fushë studimi ose në fusha të tjera të ngjashme me formimin që ofron programi Master Profesional në "Drejtësi", por edhe në fusha të ndryshme. Studenti në çdo rast regjistrohet pa debi formimi. Zyra e Pranimit të Studentëve administron procesin e regjistrimit të studentëve. Dokumentacioni i dosjes së aplikimit përmban: Formularin e interesimit/aplikimit (ky dokument mund të jetë edhe online); Kopjen e noterizuar të diplomës së nivelit të parë, Bachelor, që studentin ka fituar, shoqëruar me listë notash; CV-në e kandidatit ku të paraqiten të dhëna biografike dhe të eksperiencave profesionale; Një Letër Interesi (afërsisht 300 fjalë) ku të paraqiten objektivat profesionale, interesat kërkimore dhe nxitjet për të kryer studimet në këtë program; Një projekt- ide ku të paraqiten interesat e tij shkencore; Dy Letra Rekomandimi të cilat garantojnë kompetencën profesionale, përgatitjen akademike dhe mundësinë e kandidatit për të kryer studime të nivelit Master; Paraqitja e një dokumenti që tregon aftësitë e kandidatit në njohjen e një gjuhe të huaj përbën një avantazh. Përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Numri i studentëve të regjistruar në pranim Master Profesional në "Drejtësi" me profile ka ndryshuar nga viti në vit: gjatë 2016-2017 ishte 47 studentë, gjatë vitit akademik 2015-2017 ishte 67 dhe gjatë 2014-2015 ky numër ishte 41 studentë, ndërsa për vitin 2017-2018 numri është 30 studentë. Sipas RVB (fq. 46) arsyet lidhen me vendosjen e kriterit të mbrojtjen së gjuhës së huaj në hyrje që nisi të zbatohet sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë. Ky numër krahasuar me numrin total të studentëve të regjistruar në Fakultetin e Drejtësisë është rritur, përkatësisht 14% të totalit gjatë vitit akademik 2014-2015 në 19% gjatë vitit akademik 2016-2017, por ka pësuar një ulje gjatë vitit të fundit akademik, ndikuar kjo edhe nga kuadri i ri ligjor i hyrë në fuqi (sipas diskutimeve në IAL, si edhe me vetë studentët).

UET ofron bursa të plota apo të pjesshme për kandidatët, si ato të ekselencës (për studentë me mesatare mbi 9.5), sociale (për ata që nuk kanë mundësi ekonomike apo vijnë nga shtresa të marginalizuara dhe janë me mesatare mbi 7), të lidhshme (për ata që janë të angazhuar në organizata politike ose jo dhe që tregojnë aftësi lidhshme në kauza të rëndësishme dhe janë me mesatare mbi 8) apo talentit (për ata me arritje në fushën e sportit, artit, kulturës), një mundësi kjo e ofruar edhe për programin e masterit në shqyrtim. Studentët përfitues në këtë rast janë të detyruar të kryejnë disa orë pune që lidhen me aktivitete të UET si në klubet studentore, pranë zyrës së pranimeve (përkthime), apo asistuar në punime shkencore, etj. Gjatë vitit akademik 2015-2016 janë akorduar gjithsej 7 bursa për studentët e masterit. Nuk ka të dhëna të tjera për bursa të ofruara në vitet në vijim.

Procedura e pranimit është e normuar në pikën 2 të rregullores mësimore të programit të studimit të ciklit të dytë. Aplikimet shqyrtohen nga departamenti përgjegjës dhe miratohen nga dekani i Fakultetit. Koordinatorja e Departamentit komunikon me aplikantët për vënien në dijeni të vendimit përkatës. Lista përfundimtare e studentëve të pranuar shpallet zyrtarisht (jo më vonë se dy javë nga fillimi i vitit akademik).

Studentët mund të sigurojnë informacionin e nevojshëm nga strukturat përkatëse të UET të ngritura, ku përfshihen:

- koordinatorët e departamenteve për informacione të ndryshme
- pedagogët për informacione akademike për lëndët e tyre
- sekretaria mësimore për ecurinë e studimeve
- zyra e kujdesit ndaj kujdesit, dekani i studentëve, zyra e karrierës për jetën jashëkurrikulare, si për aktivitete të ndryshme, mundësi intershipi, punësimit, etj.

Studentët përfshihen në organet vendimmarrëse të UET, si NJSBC, Këshilli i etikës, Senati, Gjithashtu, ata kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Departamentit.

Të dhënat e RVB-së u kërkuan të konfirmoheshin edhe me Sekretarinë e IAL-së nga GVJ-ja. Këto të dhëna përputheshin me dokumentacionin e mbajtur me përjashtim të një rasti, ku një student ka ndërruar profilin, por që në total numri i tyre përputhej.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Shih Tabela 17/1 dhe 2)

Në lidhje me cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve për tre vitet e fundit, GVJ kërkoi dhe iu vu në dispozicion dokumentacioni përkatës. Në bazë të këtyre të dhënave për notën mesatare në hyrje rezultojnë këto të dhëna:

- për vitin 2015-2016, **42** studentë të regjistruar në program, nota mesatare në hyrje ishte **7.55** (më e larta 9.85 dhe më e ulëta 5.15)
- për vitin 2016-2017, **21** studentë të regjistruar rishtazi, nota mesatare në hyrje ishte **6.76** (më e larta **8.16** dhe më e ulëta **5.27**)
- për vitin 2017-2018, 39 studentë të regjistruar, nota mesatare në hyrje ishte 6.36 (më e larta 8.3 dhe më e ulëta 5.2).

Në bazë të këtyre të dhënave për notën mesatare në dalje rezultojnë këto të dhëna:

- për vitin 2014-2015 janë diplomuar gjithsej 17 studentë; nota mesatare në dalje ishte 7.68 (më e larta **9.61** dhe më e ulëta **6.17**)
- për vitin 2015-2016 janë diplomuar gjithsej 20 studentë; nota mesatare në dalje ishte **6.88** (më e larta 9.8 dhe më e ulëta 5.5)
- për vitin 2016-2017 janë diplomuar gjithsej 29 studentë; nota mesatare në dalje ishte 7.92 (më e larta 9.9 dhe më e ulëta 5.17).

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Për vitin akademik 2016-2017 janë diplomuar gjithsej 29 studentë me notë mesatare në dalje ishte 7.92. (Shih Tabela 17/2)

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Nuk ka të dhëna për mobilitet të studentëve në këtë program masteri që shqyrtohet.

Të dhëna për punësimin e studentëve (Tabela nr. 16)

Për programin e studimit Master Profesional në Drejtësi në lidhje me numrin total të të punësuarve rezultojnë këto të dhëna (sipas RVB):

- Për vitin akademik 2011-2012: nuk ka të dhëna
- Për vitin akademik 2012-2013: 5 të punësuar në përputhje me diplomën dhe 1 jo në përputhje me të;
- Për vitin akademik 2013-2014: 5 të punësuar në përputhje me diplomën;
- Për vitin akademik 2014-2015: 4 të punësuar në përputhje me diplomën dhe 7 jo në përputhje me të;
- Për vitin akademik 2015-2016: 4 të punësuar në përputhje me diplomën dhe 6 jo në përputhje me të.

Për të mbështetur studentët e diplomuar në punësim, UET organizon aktivitete si panairi i punës, që u mundëson atyre kontakte të drejtpërdrejta me përfaqësuesit e kompanive të ndryshme në vend. Panairi i Punës për vitin akademik 2017-2018 ishte organizuar në maj 2018. Po ashtu, Bordi i Punës siguron një urë lidhëse midis studentëve dhe praktikës; anëtarët e shoqatës Alumni ftohen të janë pjesë aktive e këtyre bordeve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Të gjithë studentët që kanë aplikuar dhe janë pranuar në këtë program studimi kanë përfunduar studimet e ciklit të parë “Bachelor” dhe kanë grumbulluar numrin e kërkuar të krediteve.
Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	Pranimi në këtë program studimi bëhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH”.
Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimi të përcaktuara	Institucioni përthith idetë që vijnë nga fokus grupet, diskutimet me studentët, me ish studentët dhe me bordet e punës.

<p>nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Si rezultat i diskutimeve në fokus grupe me studentët dhe me bordet e punës, por edhe me strukturat e institucionit, studentët kanë informacion për mundësitë e punësimit.</p> <p>Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit, akreditimin e programit të studimit, si edhe kanë këshillim karriere. Kjo u konfirmua edhe nga takimi i GVJ-së me studentët.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e</p>	

studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;

Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;

Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.

Institucioni disponon të dhëna të plota në lidhje me studentët pjesë e programit, ecurinë e tyre, tërheqjen dhe transferimin. Ky informacion u konsultua nga GVJ-ja lehtësisht në institucion: mbi baza kampioni u kontrolluan dhe dosjet e studentëve.

Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;

Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.

Institucioni mban një bazë të dhënash për punësimin e të diplomuarve.

Institucioni ka informacion edhe për studentët që vijojnë studimet e mëtejshme.

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;

Studentët informohen në mënyrë të rregullt për programin e studimit, organizimin e tij, përmes faqes së internetit, guidës së përgatitur për këtë qëllim (shih: https://issuu.com/uet.edu.al/docs/broshura_uet_2017-2018_print).

Studentët informohen për vlerësimin e tyre. Pas çdo forme

<p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>vlerësimi, studentët kanë të drejtën e konsultimit me pedagogun e lëndës si dhe ankimit, kjo në përputhje me pikën 5 të Rregullores së Programit. Sipas këtij parashikimi rezulton se ngrihet një komision për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar. Vlerësimi përfundimtar i dorëzohet më pas sekretarisë.</p>
--	---

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet strukturave të tij, ndjek dhe këshillon vazhdimisht studentët në problematikat që ato hasin.</p> <p>Nga takimi që GVJ realizoi me studentët rezultoi që praktika mësimorë zhvillohet sipas kërkesës së studentëve dhe jo sipas një plani të hartuar nga ana e institucionit. Institucioni vetë nuk ofron mundësi përzgjedhjeje.</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

1. GVJ konkludoi se studentët që kanë aplikuar dhe janë pranuar në këtë program studimi kanë përfunduar studimet e ciklit të parë “Bachelor” në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH”. GVJ konkludoi se **standardi IV.1 plotësohet;**
2. Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit, si rrjedhim GVJ konkludoi se **standardi IV. 2 plotësohet;**
3. Institucioni mban të dhëna lidhur me numrin e studentëve që ndjekin programin Master Profesional ne Drejtësi, për rrjedhojë GVJ konkludon se **standardi IV. 3 plotësohet;**
4. Institucioni disponon të dhëna lidhur me punësimin e studentëve të diplomuar, për rrjedhojë GVJ konkludon se **standardi IV. 4 plotësohet;**
5. Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programin Master Profesional ne Drejtësi, për rrjedhojë GVJ konkludon se **standardi IV. 5 plotësohet.**

GVJ konkludon se standardet e lidhura me rubrikën 9 “Studentët” plotësohen plotësisht.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Kërkimi shkencor në IAL bazohet në dy shtylla kryesore: Programi i madh kërkimor “Shqipëria inovative 2015-2020” dhe Strategjia e Kërkimit Shkencor 2017-2020. Program i madh kërkimor “Shqipëria inovative 2015-2020” përmban shtatë projekte kërkimore ndër të cilët projekti “E drejta dhe institucionet publike në transformim” lidhet me programin e studimit në fjalë. Dy nga tre drejtimet e mëdha kërkimore të këtij projekti, përkatësisht “Konsolidimi i shtetit të së drejtës dhe demokracisë në Shqipëri” dhe “E drejta ndërkombëtare dhe europiane: Zhvillime aktuale dhe institucionale” kanë rëndësi për programin e studimit në fjalë. Disa nga temat e kërkimit të përfshira në këto dy drejtime të mëdha kërkimore prekin çështje relevante për programin e studimit si p.sh E drejta administrative dhe zhvillimet e saj; Migracioni në Ballkan/Shengen gjatë dhe pas krizës Siriane; Parimet dhe institucionet e së drejtës penale; Kriminaliteti dhe dënimet alternative; Masat edukuese në Kodin Penal; E drejta europiane dhe lëvizja e lirë në BE. Një pjesë e stafit akademik të programit të studimit në fjalë është i angazhuar në këtë program (edhe pse një pjesë janë larguar).

Në bazë të Strategjisë së Kërkimit Shkencor 2017-2020 (SKSh), IAL synon të shndërrohet “në një qendër ekspertize në fushën e studimeve shoqërore, humane, juridike, ekonomike dhe teknologjisë së informacionit. Synim i mëtejshëm është kthimi i UET në një qendër ekselence që të japë produkt cilësor kërkimor me kontribut të rëndësishëm në planin kombëtar dhe me ndikim rajonal. Këto synime, UET përpiqet t’i realizojë nëpërmjet bashkëpunimit me partnerë të besueshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë” (SKSh, para. 1.1, fq.1). “Drejtimi strategjik i kërkimit shkencor bëhet nga Zv. Rektori për Kërkimin Shkencor, Metodologjinë dhe Cilësinë në bashkëpunim me Zyrën e Kërkimit Shkencor dhe Studimeve Doktorale si dhe Senatit Akademik të cilët monitorojnë dhe vlerësojnë ndërtimin e SKSH-së me një vizion afatmesëm dhe afatgjatë, mbikëqyrin zbatimin e saj dhe përditësojnë prioritetet e kërkimit shkencor në përputhje me synimet e UET.” (SKSh, para. 4.2., fq.2) Fakultet dhe Departamentet janë përgjegjëse për drejtimin e këtij kërkimi shkencor. Performanca e stafit akademik bëhet nëpërmjet Indikatorëve të Performancës (SkSh, para. 4.4, fq. 3) Kjo Strategji u referohet Projekteve të Mëdha Kërkimore të përmendura më lart duke i cilësuar ato si “shtyllën e kërkimit shkencor në UET” (SKSh, para. 7, fq. 4). Këto Projekte së bashku me Bordin e Botimeve në UET (IAL), revistën Polis, Ditët e Studimeve Shqiptare janë të lidhura me programin e studimit në fjalë. Kërkimi shkencor financohet nga fonde të brendshme dhe të jashtme (financime, donacione). Stafit akademik mund t’u akordohen fonde kërkimore për të ndërmarrë projekte të caktuara ose si shpërblime për publikime (SKSh, para. 14.3, fq. 9). Sipas RVB, IAL vë në dispozicion të kërkimit shkencor 500.000 Eur në vit (RVB, fq. 53).

Nga takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Projekteve për Kërkim dhe Zhvillim, rezultoi se IAL ndjek një politikë të dyfishtë lidhur me kërkimin shkencor: stafi akademik trajnohet në mënyrë të vazhdueshme por në të njëjtën ky staf përballë me detyrime lidhur me produktin akademik. Përbushja e këtyre detyrimeve identifikohet nëpërmjet sistemit të pikëzimit (Indikatorët e Performancës). Si pjesë e procesit të konsolidimit të kërkimit shkencor, Revista juridike Ius & Iustitia është mbyllur; botimet juridike përfshihen në Revistën Polis. Sipas bisedës me

përgjegjësin e kërkimit shkencor, kjo revistë siguron hyrje pa pagesë online dhe bazohet në vlerësim të anonimizuar të artikujve shkencorë. Kjo revistë është e hapur për publikime nga stafi akademik i programit të studimit në fjalë. Lidhur me mobilitetin e stafit akademik, në momentin e vizitës në IAL rezultoi se përgjegjësjë e departamentit të së drejtës publike dhe një anëtar i stafit akademik ishin shkëputur për një periudhë kërkimi në institucione akademike ndërkombëtare.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor – Për më shumë shih Tabelat 18, 19, 20

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Personeli efektiv i IAL ka 150 botime për vitin 2016-2017, 120 për vitin 2015-2016 dhe 186 për vitin 2014-2015 (për më shumë shih Tabelën 19). Bazuar në CV-të e personelit akademik efektiv të programit të studimit në fjalë për vitin 2017-2018, gjendja është si me poshtë:

- Erjona Canaj – 5 monografi nga të cilat një ribotim/përditësim; 1 përkthim të një teksti bazë mësimor; 27 artikuj në Jus & Justitia, Polis, Mediteranean Journal of Social Sciences, Economicus etj;
- Ledina Shkurti – 2 ligjërata në Universitetin e Toulon-it në vitin 2013 (përpara punësimit në IAL);
- Redion Luli – 3 artikuj në Scientific Bulletin of Moscow State Technical University of Civil Aviation № 216, Moscow 2015; Law & Legislation № 12, Moscow 2014; Bulletin of People's Friendship University of Russia №4, Moscow 2014 (përpara punësimit në IAL);
- Afërdita Tepshi – 5 conference proceedings dhe një artikull në Jus & Justitia;
- Adrian Papajani – 2 monografi dhe tekste universitare (para punësimit në IAL dhe me fokus në studimet historike, të drejtat e pakicave, kërkimi shkencor, mirëqënia dhe politikat sociale). Një numër artikujsh shkencorë me fokus pedagogjinë, historinë, etj;
- Evelina Çela - 2 artikuj të botuar në revistat shkencore në Shqipëri, 4 artikuj të botuar në revistat shkencore jashtë vendit, 2 referime në konferenca shkencor në rusisht.

Numri i projekteve kërkimore të fituara

Rezulton se ka një ulje të numrit të projekteve kërkimore të fituara nga viti 2015 në vitin 2017: 2015 - 8; 2016 - 2; dhe 2017 - 1. Për më shumë shih tabelën 19.

Numri i projekteve të zbatuara

Rezulton se ka një ulje të numrit të projekteve kërkimore të zbatuara nga viti 2015 në vitin 2017: për vitin 2015 - 11; 2016 - 5; dhe 2017 - 4. Për më shumë shih tabelën 19.

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

Ka një rritje të lehtë të numrit të aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL nga viti 2015 në vitin 2017: 2015 - 3; 2016 - 5; dhe 2017 - 5. Për më shumë shih tabelën 19.

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL

Ka një rritje të numrit të pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL: 2015 - 70; 2016 - 80; dhe 2017 - 120. Për më shumë shih tabelën 19.

Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

Studentët përfshihen në ndonjë rast në aktivitete shkencore. Sipas tabelës 18, rezultojnë 3 studentë të përfshirë në projekte shkencore në rang Departamenti dhe 3 në punime shkencore individuale të pedagogëve Megjithatë ky fakt nuk duket se u konfirmua nga takimi me studentët të cilët nuk dhanë ndonjë shembull specifik përveç përfshirjes në Ditët Shqiptare të Studimeve. Shih edhe Tabela 19.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- ✓ Shqipëria Inovative 2015-2020
- ✓ Strategjia e Kërkimit Shkencor 2017-2020
- ✓ Projekte dhe Mobiliteti
- ✓ Grupet kërkimore
- ✓ CV stafi akademi (publikimet)
- ✓ Monografi të stafit të programit të studimit

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Një pjesë e personelit akademik publikon monografi dhe/ose artikuj shkencorë në fushën përkatëse kërkimore dhe të mësimdhënies. Për një pjesë të personelit akademik nuk ka të dhëna lidhur me publikimet. Një pjesë ka publikime por jo domosdoshmërisht në fushën kërkimore të programit të studimit në fjalë. Një pjesë e personelit akademik ka marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare ku ka prezantuar punën kërkimore.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Mësimdhënia në gjuhë të huaj ndodh në rastet e studentëve të huaj pjesë e programeve të shkëmbimit. Megjithatë IAL nuk ka projektuar dhe zbatuar lëndë në gjuhë të huaj; qasja është individuale me leksione individuale për studentët e huaj. Personeli akademik i përfshirë në këtë praktikë (një rast i evidentuar gjatë vizitës në institucion) ka kryer studimet në atë gjuhë.</p>

Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor;

Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.

IAL ofron mundësi mobiliteti stafit akademik. Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion (takimi i realizuar me personelin e programit) rezultojnë të paktën tre raste mobiliteti të stafit akademik të programit të studimit në fjalë. Gjithashtu gjatë bisedës në institucion me përfaqësues të zyrës së kërkimit shkencor dhe projekteve rezultoi se stafit akademik u ofrohen trajnime/ programe për kualifikimin profesional e vazhdueshëm në fushën e kërkimit shkencor.

Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

IAL disponon një bazë të dhënash për veprimtarinë kërkimore shkencore, pjesëmarrjen në konferenca si dhe botimet e stafit akademik. Një burim i këtyre të dhënave janë jetëshkrimet e secilit anëtar të stafit akademik. Gjithashtu IAL disponon një listë të detajuar të projekteve ku janë përfshirë anëtarët e stafit akademik (shih "Projekte dhe Mobiliteti") si dhe një listë të grupeve të projekteve (shih "Grupe kërkimore:").

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Një pjesë e konsiderueshme e personelit akademik publikon monografi dhe/ose artikuj shkencorë në fushën përkatëse kërkimore dhe të mësimdhënies, të cilat janë me vlerë dhe për programin e studimit, edhe pse CV-të e tyre duhet të përditësohen. IAL duhet të marrë masa për përmirësimin (sasior dhe cilësor) të output-it të kërkimit shkencor. Personeli akademik të inkurajohet të botojë në revista prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në fusha që lidhen me programin e studimit në fjalë. Gjithashtu, rekomandohet të bëhet një integrim më i mirë i aktivitetit të personelit akademik të programit të studimit në fjalë në kornizën e strategjisë së kërkimit dhe platformës Shqipëria Inovative. Për këto arsye, **standardi III.3 plotësohet kryesisht.**
2. Mësimdhënia në gjuhë të huaj ka karakter ad hoc duke qenë se IAL nuk ka si pjesë të planit mësimor lëndë në gjuhë të huaj; qasja është individuale me leksione individuale për studentët e huaj. Për këtë arsye, **standardi III.4 plotësohet pjesërisht (de facto,**

por pa kurs të planifikuar në planin mësimor).

3. IAL i ofron mundësinë e kualifikimeve të vazhdueshme stafit akademik nëpërmjet vizitave kërkimore-shkencore ose periudhave të mësimdhënies në universitete të huaja. Gjithashtu IAL i ofron stafit akademik trajnim të vazhdueshëm si dhe mundësinë e pjesëmarrjes në aktivitete kërkimore-shkencore (Ditët e Studimeve Shqiptare) si dhe në projektet/grupet kërkimore. Për këto arsye, **standardi III.10 plotësohet.**
4. IAL disponon një bazë të dhënash për veprimtarinë kërkimore shkencore, pjesëmarrjen në konferenca si dhe botimet e stafit akademik. Për këtë arsye, **standardi III.11 plotësohet.**

GVJ konkludon se standardet e lidhura me rubrikën 10 “Kërkimi shkencor” plotësohen kryesisht.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Që nga krijimi i tij, bazuar edhe në misionin e tij, UET ka arritur të vendosë ura bashkëpunimi shkencor dhe profesional me institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit si dhe me aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile, sektorit publik e privat, në funksion të krijimit të mundësive të ndryshme për studentët dhe stafin akademik. Gjithsej rezultojnë të jenë realizuar 125 marrëveshje, me IAL të huaja dhe IAL të brendshme, qendra kërkimore si edhe me fondacione, apo institucione brenda dhe jashtë vendit. Këtu përfshihen IAL në Austri, Belgjikë, Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, Qipro, Finlandë, Francë, Gjermani, Itali, Bullgari, Izrael, Mbretëri e Bashkuar, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, etj.

Rezultoni se institucioni ka krijuar një rrjet të gjerë marrëveshjesh me mjaft institucione të administratës publike të komunitetit të biznesit, dhe organizatave jofitimprurëse në vend, përfaqësive diplomatike të huaja në vend, etj, si Këshilli Britanik, Ambasada e ShBAve, NUFFIC - Ambasada Hollandeze, World Vision, AMSHC, Komisioni Evropian, etj.

Institucioni i ka kushtuar rëndësi pjesëmarrjes në disa programe të Bashkimit Evropian, si TEMPUS, Jean Monnet, Erasmus+, Horizont 2020, Visegrad University Fund, etj. Nga të dhënat statistikore, rezultoni se ka pasur programe shkëmbimi si midis pedagogëve ashtu edhe studentët. Një ndër rrjetet me rëndësi ku UET ishte iniciuese ishte rrjeti Next Europe 2014-2015 me fokus vendet e Ballkanit. Gjithashtu, UET është pjesë e rrjeteve ndërkombëtar e si partner si SEUN, UNIMED, FEDE. UET ka edhe marrëveshje institucionale për kërkimin shkencor me universitetin e La Sapienza, Itali si dhe CEU, Hungari për shkëmbim stafi akademik.

UET ka ndërtuar mekanizma për ndërlidhje me tregun e punës, sferën e biznesit, etj. Çdo Departament ka krijuar Bordin e Tregut të Punës, ku marrin pjesë figura të ndryshme dhe që shërbejnë për arritje në fushën e programeve të studimit që administrohen nga departamenti. Këto Bode ofrojnë këshillime për të rritur përputhshmërinë e diplomave me tregun e punës, si dhe për të lehtësuar procesin e praktikave profesionale të studentëve, si edhe punësimin e ardhshëm të tyre.

Institucioni zhvillon çdo vit, në maj, Panairin e Punës për të lehtësuar kontaktin e studentëve me kompani nga më të rëndësishmet në Shqipëri, me synim punësimin e mundshëm të

studentëve në to. Periudha kohore e zhvillimit të Panairit të Punës, përkon me fundin e vitit akademik, me qëllim që t'i jepet mundësia e punësimit studentëve që ndodhen në prag diplomimi.

Nga vizita në institucion dhe nga bashkëbisedimi me studentët, rezultoi se aktualisht nuk ka marrëveshje midis UET-së dhe institucioneve apo organizatave të tjera me qëllim zhvillimin e praktikës mësimore me studentët e programit Master i Profesional.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Të dhënat në vijim duhet theksuar se nuk kanë lidhje vetëm me programin e studimit Master Profesional në Drejtësi me profile, por i referohen UET në tërësi (shih Tabela 20) :

- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime: 2017 2 (dy)
- Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj: 2015-2017 2 (dy) të tillë
- Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare: gjatë vitit 2016 1 (një) i tillë
- Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL: studentë të huaj në master shkencor 2016-2017 1(një) / studentë nga UET drejt IAL evropiane 2016-2017 1 (një)
- Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor: Ditët e studimeve shqiptare, Grantet e Përvitshme Kërkimore të aplikuara deri në vitin 2017; Ditët doktorate, revistat shkencore Economicus dhe Polis, ditë informative për grante kërkimore në nivel evropian (AKTI, RCE, etj)

Nga takimi me pedagogët dhe studentët në institucion, nuk rezultoi që këto programe të kenë përfshirë studentë të programit të studimit Master Profesional në Drejtësi, edhe pse në tërësi, gjatë viteve 2015-2017 rezultoi të jenë realizuar 107 mobilitete stafi dhe studentësh të UET drejt universiteteve partnere, ndërkohë që 18 staf dhe 13 studentë kanë ardhur në UET përmes bursave Erasmus+ (Shih RVB fq. 53. para. 4).. Në lidhje me pedagogët u konstatuan raste të aplikimit të vitit sabbatik nga përgjegjësja e departamentit Znj. Mandia. Pedagogët i konfirmuan GVJ se kishin përfituar nga Jean Monnet 2013 për shembull për përmirësimin e veprimtarisë akademiko-shkencore në lëndë si të drejtat e njeriut.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se Universiteti Evropian i Tiranës ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi më disa institucione dhe konkretisht:

UET rezultoi të ketë nënshkruar marrëveshje me 94 partnerë IAL të huaj universitete (për shkëmbimin e studentëve dhe të stafit akademik, si edhe forma të tjera bashkëpunimi apo për realizimin e projekteve evropiane si Erasmus+, Tempus, Sigma, etj.), 15 partnerë vendas universitete (marrëveshjet e bashkëpunimit synojnë realizimin e projekteve evropiane por edhe

forma të tjera bashkëpunimi), 16 institucione të shoqërisë civile si partnere apo donatorë (RVB fq. 59-64).

Lidhur me Erasmus+, rezulton që në UET sapo është mbyllur procesi i aplikimeve dhe intervistave për studentët që do të kryejnë shkëmbimin e tyre nisur nga Shkurti 2018, dhe kjo reflekton një mundësi të mirë për që studentët të njihen me kurrikulat e universiteteve të huaja, u krijon hapësira për të praktikuar gjuhën e huaj në terma ligjorë, u krijon mundësi për të njohur qasjen e pedagogëve ndaj temave dhe zhvillimeve më të fundit në drejtësi, për të marrë pjesë dhe për të 'testuar' njohuritë e fituara deri tani, mundësi për network, etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Studentët e programit të studimit Master Profesional në Drejtësi me Profile, e zgjedhin vetë vendin/institucionin ku kryejnë praktikën profesionale pasi universiteti nuk ofron në mënyrë të pavarur institucionet ku mund të zhvillohet praktika për ta. Edhe këtë vit akademik 2017-2018 institucioni nuk ka ndjekur praktikën e marrëveshjeve paraprake me institucionet ku studentët mund të zhvillojnë praktikën profesionale, por ka ofruar komunikime shkresore për studentë, sipas nevojave, për lehtësimin e realizimin të praktikës së gjetur nga vetë studenti.</p> <p>Nga informacioni i paraqitur në RVB, si dhe kërkimi që GVJ realizoi rezulton që UET ka një sërë marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme.</p> <p>GVJ rekomandon që të tilla marrëveshje duhet që paraprakisht të lehtësojnë lehtë studentët në përzgjedhjen e institucionit për zhvillimin e praktikës profesionale.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda</p>	<p>Informacioni shkëmbehet rregullisht midis anëtarëve të personelit akademik, si edhe ka një bashkëpunim të mirë. Një sërë konferencash, simpoziumesh, botimesh në revista, etj., e evidentojnë këtë.</p> <p>Ka një ndarje të detyrave midis anëtarëve të personelit akademik e cila mundëson marrjen e përgjegjësisë dhe garanton bashkëpunimin midis</p>

institucionit, marrjes së përgjegjësiwe respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	stafit akademik. Po kështu, drejtuesit e departamenteve kanë përgjegjësi të qarta në nxitjen dhe vlerësimin e kërkimit shkencor nga personeli akademik.
---	---

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga ana e Institucionit, ka një sërë marrëveshjesh më qëllim realizimin e objektivave të këtij program studimi.</p> <p>Institucioni nuk ka marrëveshje të mirëfillta për kryerjen e praktikës mësimore, por e lë në dorë të studentit të realizojë këtë element të programit, i cili vlerësohet për zhvillimin e praktikës së zgjedhur nga ajo/ai vetë, sipas mundësive dhe oportuniteteve që atyre u krijohen. Ndonëse nga njëra anë kjo procedurë krijon vështirësi për studentin për të zhvilluar praktikën në një institucion sipas një marrëveshjeje paraprake nga universiteti, nga ana tjetër i mundëson atij të njihet me realitetin e punësimit dhe të përballet individualisht, dhe kjo ka ndikim pozitiv në rritjen e aksesit të tij në tregun e punës.</p> <p>Institucioni ka realizuar pjesëmarrjen me disa lektorë të ftuar por ato mbeten në numra të pakët.</p> <p>Rregullisht nga strukturat e Institucionit, hartohen raporte analitike në funksion të programeve të studimit.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj që mund të ndihmojnë në parim kryerjen e praktikave por nuk ka marrëveshje konkrete për programin e studimit për këtë qëllim duke e lënë këtë element në zgjedhjen e vetë studentëve, prandaj konkludon që **standardi V. 3 plotësohet, me sugjerimin e lehtësimit konkret të praktikës studentëve përmes marrëveshjeve dhe ndjekjes së zbatimit të tyre nga IAL-ja;**
2. Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij, si rrjedhojë GVJ konkludon që **standardi VII.1 plotësohet.**
3. Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj, si rrjedhojë GVJ konkludon që **Standardi VII.2 plotësohet.**

GVJ konkludon se standardet e lidhura me rubrikën 11 “Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun” plotësohen plotësisht, me sugjerimin më sipër.

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitën në institucion, GVJ ka vlerësuar plotësimin e rekomandimeve që burojnë nga Vendimi nr. 133, datë 21.12.2010 i Këshillit të Akreditimit dhe konkludon si më poshtë:

Rekomandimet e mëposhtme janë plotësuar plotësisht:

- a) "Të forcohet roli i strukturave kontrolluese për rritjen e efektivitetit sidomos në fushën e kërkimit shkencor".
- b) "Në departamente të krijohen grupet mësimore kërkimore si njësi bazë për të menaxhuar më mirë si mësimdhënien ashtu edhe aktivitetin kërkimor".
- c) "Fakulteti/Departamentet të shohin me përparësi rritjen e shkallës së kualifikimit të personelit akademik, që të gjithë titullarët e lëndëve të kenë gradën shkencore doktor".
- e) "Të aktivizohen më shumë ekspertë, edhe me statusin e "guest speaker", për të realizuar më mirë shkëmbimin e përvojave edhe me universitetet e tjera".
- f) "Në të gjitha programet të mos lejohet dhënia nga një titullar e më shumë se dy lëndëve".
- g) "Të behet i detyrueshëm disponomi i materialit bazë (leksione të shkruara) në shqip".
- h) "Të normohet numri i faqeve të leksioneve të shkruara në rreth 10-15 faqe për leksion".
- j) "Kurrikulat të përcaktojnë më thjeshtë dhe më qartë literaturën bazë të detyruar, pasi në disa lëndë ajo është e mbingarkuar".
- l) "Të harmonizohet më mirë shpërndarja e mësimdhënies në kohë gjatë javës".
- m) "Të vazhdohet puna e nisur me Universitetet perëndimore, me të cilat janë lidhur marrëveshje dhe mundësisht, të shtohen kontaktet me universitetet e tjera".
- n) "Të shihet mundësia e aplikimit të ndonjë modeli perëndimor në plotësimin e përmirësimit e planeve mësimore".
- o) "Të përmirësohet bashkëpunimi me universitetet në vend, për të thithur kontingjente të interesuara për ciklin e studimeve DND, MNP e MND në UET, duke ekspozuar më mirë kriteret e pranimit".
- q) Të shihet mundësia e aplikimit të kriterit të mesatares, mbase dhe ajo e përdorimit të gjuhës angleze, për studentët e diplomave DND, MNP e MND".
- u) "Të rritet më tej përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor".

Rekomandimet e mëposhtme janë plotësuar kryesisht:

- t) "Të synohet botimi i monografive me interes për institucione kërkimore shkencore brenda e jashtë vendit".
- v) "Të pasurohet më tej fondi i bibliotekës edhe me literaturë të huaj dhe literaturë në shqip, kryesisht në funksion të plotësimit të nevojave të kurrikulave".

Rekomandimi i mëposhtëm është plotësuar pjesërisht:

- k) “Të shikohet mundësia e ngarkesave në planet mësimore për ta bërë më intensiv procesin e angazhimit të studentit (diferencime në numrin e krediteve për lëndë të veçanta)”.

Rekomandimet e mëposhtme nuk lidhen me këtë program studimi:

- d) “Institucioni të punojë për punësimin me kohë të plotë të personelit të brendshëm dhe të mos lejojë dy punësimin me kohë të plotë”.
- i) Të rishikohet profilizimi më i qartë i disa planeve mësimore si MNP Shkenca Komunikimi, MND Marrëdhënie Ndërkombëtare, etj”.
- p) “Të rriten e forcohen kontaktet me punëdhënësit brenda e jashtë vendit për të rritur sigurinë e punësimit të studentët”.
- r) “Të shihet mundësia e uljes së tarifës të studimeve duke vendosur raporte më eficiente në shpenzimet psh., reklamën publicitare, për të rritur më tej interesimin e kontigjenteve më cilësore”.
- s) “Të rriten të ardhurat nga aktiviteti kërkimor, duke u angazhuar në tematika që kanë interes për ekonominë e vendit tonë”.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES-PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) IAL i ofron programit të studimit një infrastrukturë të qëndrueshme.
- 2) Programi i studimit funksionon mbi bazën e një personeli akademik me kualifikimet akademike përkatëse. Në përgjithësi personeli akademik ka qenë i qëndrueshëm.
- 3) Staf i ndihmës (administrata, sekretaria mësimore) është një mbështetje e madhe për programin e studimit.
- 4) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e ngritur prej disa vitesh dhe e qëndrueshme.
- 5) Qasja për planifikim afatgjatë të kërkimit shkencor nëpërmjet Strategjisë së Kërkimit Shkencor dhe Platformës “Shqipëria Inovative”.
- 6) Aktivitete shkencore/kërkimore të organizuara në IAL (si p.sh Ditët e Studimeve Shqiptare”).
- 7) Pjesëmarrja e stafit akademik në programe/projekte zhvillimore.
- 8) Bashkëpunimi ndërkombëtar me institucione të tjera akademike.

b. Pika të dobëta:

- 1) Mungesa e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet publike dhe private në Shqipëri dhe jashtë për zhvillimin e praktikës mësimore në programin e studimit në fjalë.

- 2) Mungesa e disa librave (tituj të detyrueshëm për programin) në bibliotekë si dhe përditësimi i herëpashershëm i titujve në bibliotekë.
- 3) Studimi i tregut të punës për programin e studimit.

c. Mundësitë:

1. Ekzistenca e infrastrukturës së qëndrueshme dhe vendndodhja e IAL-së në Tiranë pranë institucioneve shtetërore përbën një bazë shumë të mirë për vendosjen e kontakteve për praktikantët mësimorë.
2. Bordet e Tregut të Punës ofrojnë një mundësi të mirë të rishikimit të kurrikulave dhe përputhjes së tyre me kërkesat e tregut të punës.
3. Ka një potencial për krijimin e sinergjive të kërkimit shkencor në bazë të Strategjisë së Kërkimit, Platformës “Shqipëria Inovative” dhe eksperiencës së akumuluar nga fitimi i granteve nga palë të treta. Të gjithë këto elemente së bashku krijojnë potencialin për zgjerimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të kërkimit shkencor dhe të output-it të stafit akademik.
4. Mundësi aplikimi për grante kërkimore/për mobilitetin p.sh. në kuadër të BE.

d. Pengesat:

- 1) Mungesa e lëndëve me zgjedhje për profilet e programit Master Profesional në “Drejtësi” vështirëson përhithjen maksimale të dijeve dhe njohurive praktike në fusha sipas interesit të studentit.
- 2) Zhvillimi në raste të caktuara i moduleve të përbashkëta (për të tre profilet e programit), së bashku me programin e Masterit Shkencor, pa i diferencuar në qasje praktike dhe të profilizuara nuk diferencon formimin e studentit nga ata që do të marrin drejtim shkencor më pas në studimet e tyre të mëtejshme apo edhe në punësim.
- 3) Vështirësitë e hasura nga studentët lidhur me praktikantët mësimorë.
- 4) Mungesa e lëndëve në gjuhë të huaj ul potencialin për shkëmbim të studentëve nga vende të tjera.
- 5) Burimi kryesor i financimit mbeten tarifat e shkollimit të studentëve.
- 6) Në kushtet aktuale, kur programet e studimit në Drejtësi, po shkojnë drejt integritit të tyre, kur UET të ndërmarrë hapa drejt miratimit dhe aplikimit të programeve të integruara, do të ri-konceptojë edhe programin Master Profesional me profile, në reflektim të programit të integruar, dhe kërkesave të parashikuara në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH”.

I. A SUMMARY OF ANALYSIS ON COMPLIANCE WITH RECOMMENDATIONS FROM THE FIRST ACCREDITATION

Based on the documents submitted by the Institution, as well as site visit at the Higher Education Institution (HEI-UET), the Group of External Evaluators (GEE) assessed the HEI's compliance with recommendations of the Decision no. 133 of 21.12.2010 of the Accreditation Council (AC), and concludes as follows:

*The following recommendations have been **fully met**, by HEI:*

- a) HEI should strengthen the role of supervising units in order to increase effectiveness, especially with regards to research;
- b) Departments should establish research groups to serve as core units for a better administration of teaching process, as well as the as well as research activity;
- c) Faculty/Departments should give priority to qualification of academic personnel so that all academics leading the courses will attain the scientific title "Doctor";
- e) More experts should be involved in the teaching process, also as "guest speakers", in order to improve exchange of practices with other universities;
- f) Lecturers in all study programmes should be in charge of no more than two courses/modules;
- g) Preparation of core reading materials in Albanian language (written lectures) should become mandatory;
- h) Written lectures should be around 10-15 pages per lecture;
- j) Mandatory readings materials and bibliography should be presented in a more clear and simplified manner, because for some courses it is excessive;
- l) A better harmonization of teaching work-load along the week should be achieved;
- m) HEI should continue the work started with western universities with which agreements have been signed, and possibility, increase contacts with other universities;
- n) HEI should consider application of western curricula's in implementing and improving teaching plans/calendar;
- o) HEI should consider the improvement of collaboration with other Albanian universities in order to appeal interested students to the post graduate study programs (DND/SLD², MNP/MFL³ and MND/MSL⁴ of UET, by exposing better the admission criteria.
- q) HEI should consider the possibility of applying the criteria of 'average grade' and possibly the one of English proficiency for admission to its programmes, DND/SLD, MNP/MFL and MND/MSL of UET,;
- u) Students participation in scientific research should be increased further.

*The following recommendation has been **substantially met**, by HEI:*

² Second Level studies Diploma

³ Master of First Level

⁴ Master of Second Level



t) HEI should aim to publish the monographs, which are of interest to national and international research/scientific institutes;

v) The library should be enriched with more books and literature in Albanian and other languages, especially related to the curricula's concerned.

*The following recommendation has been **partially met** with by the HEI:*

k) Teaching plan should provide different ECTS regimes for different courses in order to make student's participation more intensive.

*The following recommendations **do not relate** to the present study programme:*

d) HEI should ensure full time employment for academic staff and should not allow full time employment in another institution;

i) Re-consider to specialize some programmes such as MNP/MFL on Sciences of Communication; MND/MSL on International Relations, etc;

p) Increase and strengthen the contacts and liaise with potential employees in Albania and abroad, to boost the employment opportunities for students;

r) HEI can consider to reduce the study fees, having thus more efficient expenses, for example advertisings, to increase further the possibility for attracting qualified students.

s) Increase of income from research activities through involvement in research activities which are relevant to the economy of our country.

II. EEG CONCLUDING SWOT (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats) ANALYSIS

a. Strengths:

- 1) HEI offers a stable infrastructure to the study programme;
- 2) The study programme functions and benefits from academic staff with the necessary qualifications. In general academic staff has been stable;
- 3) The study programme benefits highly from the support of administrative staff (secretaries and other admin staff);
- 4) The Internal Quality Control has been set up from years add it is sustainable;
- 5) A long-term approach in research through the Research Strategy and the Platform "Innovative Albania";
- 6) Scientific/research events organized by HEI such as "Days of Albanian Studies";
- 7) Participation of academic staff in research programmes/grant applications;

8) International cooperation with other academic institutions.

b. Weaknesses:

- 1) The library does not offer all mandatory titles/books for the study programme. Updating the library books and materials remains a challenge;
- 2) The absence of formal cooperation agreements with public and private institutions in Albania or abroad, for conduct of students' internship (professional practice), which is mandatory for this study programme. Absence of certain titles/books (mandatory for the programme) in the library and continuous update in the library;
- 3) The study and analyze of the employment market should reflect all profiles of this study programme.

c. Opportunities:

